

Procesverbal

Nga Mbledhja IX (e nëntë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë: 25.09.2024

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027;
3. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së Komunës P-70604038-00244-4 ZK Shajne, me sipërfaqe 12500m/2; dhe
4. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje anëtarë të Kuvendit, nënkryetar i Komunës, drejtorë të drejtorive, të gjithë të pranishmit këtu në sallë, media dhe të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit! Mirë se keni ardhë në seancën e nëntë të rregullt për vitin 2024! Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë. Para se ta qesim në votim, a do dikush me e marrë fjalën?

Uran Halimi: Përshëndetje, të nderua delegatë, qytetarë të Komunës së Dragashit, të gjithë ju të pranishëm! Sa i përket rendit të ditës, kemi diskutuar edhe në seancën e kaluar, edhe dje në KPF ne patëm një pikë të rendit të ditës të cilën unë kërkoja me e fut në rend të ditës. Gjeta mbështetjen edhe të kryetarit, edhe të pozitës në atë rast. Edhe u votua me shumicë votash. Kryesuese, në fakt unë e kam të njëjtën kërkesë prapë, themelimin e Komisionit për hetimin e mirëmbajtjes së veturave të Komunës. Është e njëjta kërkesë, si në seancën e kaluar, meqenëse ajo mbet në gjysmë edhe tash duhet me u kthye në pikën zero. Faleminderit shumë!

Nedžmidin Sejdir: Unë gjithashtu e mbështes propozimin e z. Halimit lidhur me formimin e një komisioni që duhet të hetojë akuzat për keqpërdorim të fondit lidhur me mirëmbajtjen e veturave komunale. Kam folur edhe për seancat që nuk kanë kuorum për pikën, ndoshta qytetarët janë të shqetësuar, nuk e dinë se çfarë po ndodh në komunën tonë. Unë propozoj ndryshimin e rendit të ditës. Le ta vendosim pikën eventuale si pikën e dytë të rendit të ditës dhe më pas do të shqyrtojmë buxhetin dhe gjëra të tjera. Për buxhetin, nëse nuk i siguron votat, ne nga opozita do t'ju ndihmojmë. Në mënyrë që të tjerët të mos ikin nga seanca, ju kërkoj të ndryshoni rendin e ditës. Se pika e parë pas raporteve procedurale mund të jetë, pastaj pjesa tjetër. Është koha që t'u jepet delegatëve të drejtën për t'i bërë pyetje ekzekutivit, pyetje që i shqetësojnë qytetarët.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën rreth rendit të ditës? Në qoftë se nuk ka, atëherë ishte propozimi i Uran Halimit që edhe në seancën e fundit, që ky Komision është

votuar nga të gjithë asambleistët. Por, e dish si shkoi puna, deri në atë pikë sa që mbet salla pa kuorum. Për atë arsye edhe nuk e kam qit në rend të ditës. Por, ti e bone edhe si propozim, atëherë ne do ta qesim këtë pikë në votim. Sa i përket Sejðilarit, pika eventuale të vendoset pas procesverbalit, jo që edhe unë nuk kam dëshirë të vendoset ajo pikë, por unë i kam shikuar të gjitha asambletë komunale dhe asnjë asamble pikën eventuale nuk e ka para pikave kryesore. Të njëjtat mundeni me m'i pru. Në qoftë se ne do ta vëmë pikën eventuale pikët të parë, atëherë shumica e asambleistëve nuk do të vijnë dhe a do të mundim ne pastaj ta nisim seancën. Kështu që, këtë pikën eventuale unë personalisht do të lë aty ku ka qenë gjatë 18 viteve në seancë. Ose edhe e qesim në votim? Okej. Atëherë, pikat e rendit të ditës veç i dini. Kush është pro propozimit të Uran Halimit, formimin e Komisionit hetimor për mirëmbajtjen e automjeteve? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro edhe 13 kundër, atëherë më detyrohet ta përdori votën e dyfishtë. Do të jetë kundër. Pika që e propozoi Urani Halimi nuk do të jetë pikë e rendit të ditës. Atëherë, do ta vazhdojmë, pikën eventuale ta qesim si propozim i Nedžmidin Sejðilarit. Kush është pro që pika eventuale të futet si pikë e dytë e rendit të ditës, pas procesverbalit? A ka kundër? Abstenim? Me 11 vota pro, 14 kundër dhe zero abstenim, nuk kalon edhe kjo pikë. Atëherë, e qesim rendin e ditës ne votim, pa ndryshime. Kush është pro? A ka kundër? A ka abstenim? Me 14 vota pro, 11 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Atëherë, fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kush do me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë të rendit të ditës. Fillojmë te pika e dytës: Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027. E hapi diskutimin.

Shpetim Hajredini: Përshëndetje, ekzekutiv i nderuar, kolegë e kolege asambleistë, qytetarë të nderuar të Dragashit! Natyrisht, nuk do të filloj fjalimin tim për buxhetin fare në këtë moment. Do të lidhem me atë pikën dhe atë kërkesën që e bëri Urani. Unë po befasohem se si ndodh, brenda dy jave a tri nga seanca e kaluar, ku ky propozim mori mbështetje edhe nga ekzekutivi, dhe tani nuk e mbështet askush. Çka ka ndodhë, kryetar, nuk po e di. Kryesuesja me dy vota edhe na mposhti. Na votuam dhe kjo na mposhti, po nuk është problem, kjo e di vetë çka merr vendim, për apo kundër. Por kryetari në atë seancë ishte shumë i bindur se ky Komision duhet të formohet. Pse sot, kryetar, je kundër? Çka u bo, çfarë frike ke? Hajt se po ta lëshoj videon tash e dëgjojsh kryetarin t'u thonë që duhet ta mbështesim të gjithë. Merre fjalën pastaj edhe mujsh ti me m'replikue mu, se je mësue prej vendit ti veç me folë. Na jena këtu për me hup kohë, s'jena na për me ik prej këtuhit. Na jemi këtu për me folë, me e thënë mendimin tonë. Ti s'mujsh me ma ndërpre mu fjalën, me m'tregue mu a duhet me dalë me folë a s'duhet me dalë. Për mu ti je askushi. Ta Samidin, unë kam respekt për ty edhe e din ti mirë atë. Po e them në opinion atë që është e drejtë dhe e vërtetë. Nëse nuk është e vërtetë, del ti këtu edhe kundërshto. Nëse, ajo po kuptohet se për çka nuk u votue ky propozim i Uranit, ne e dimë të gjithë, edhe qytetarët jam i

bindur që e kuptojnë pse nuk votohet një propozim. Tjetra, është kërkuar edhe nga ana jonë e Grupit të PDK-së, edhe pse realisht edhe ne nuk e kemi gjithmonë, deri në fund të seancës të gjithë asambleistët prezentë. Por kena kërkuar që eventualja të jetë në fillim të seancës, vetëm për këtë arsye, sepse po ikin asambleistët. Dhe ne katër-pesë seanca, të themi për tri vite bon vaki i kemi 10 seanca që nuk e vazhdojnë seancën deri në fund dhe pika eventuale nuk mbahet, gjë që është shumë e rëndësishme për qytetarët. Në këtë moment, prapë ekzekutivi dhe asambleistët e pozitës nuk e mbështetën. Kjo për mu me të vërtet nuk është në rregull. Të kërkoj diçka për të mirën e qytetarëve, të jesh kundër, absolutisht unë nuk mund t'i kuptoj këta, pse votojnë kundër. Kisha shumë me folë, po realisht më ndërhyri ta Samidin edhe pak më qiti prej sistemit. Pas diskutimeve që do t'i bëjnë edhe anëtarët tjerë, do ta marr fjalën prapë buxhetin, do të diskutojmë dhe do ta vazhdojmë seancën. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Para se me ua dhënë fjalën të tjerëve, Shpetim, jo se unë nuk dua të qitet pika eventuale si pikë e dytë e rendit të ditës. Por, ju si Grup, a mundeni me i pru krejt asambleistët në kohë me fillue seanca? Kjo duhet me më dhënë mu siguri, se ka që nuk vijnë. E dyta, sa për Komisionin, unë e kam votue pro, edhe para qytetarëve, absolut nuk jam e zhgënjyer që kam votue. Por, duke i parë rrethanat atë ditë në Asamble, në pikën eventuale unë do ta diskutoj. Do të lë rendi Propozim – vendimit. Kush është veç për rendin e ditës? Tash kush do vetëm për buxhetin me e marrë fjalën, në pikën eventuale do të rrini të gjithë dhe do t'i diskutojmë krejta.

Artan Loshaj: Përsëritet për të gjithë! Znj.Kryesues, tash na erdh edhe një material shtesë, qysh e keni zanat. S'po e dini cilin me ia nis me e diskutue. Është i pesti apo i gjashti qe tre muaj që ndërrohet. Po ne jse, qytetarët e dinë këtë edhe nuk është risi. Unë do të vazhdoj dje që kam diskutue me kryetarin në Komitet. Ky për mu është i pavlefshëm, se s'mundim me e kqyr na për tre minuta, se s'jemi super të mençur, smart, qysh ke ai muhabeti dje i drejtorit. Unë due pak a shumë te buxheti me ia nis. Pika numër 2: Ndërtimi i rrugëve në qytezën e Dragashit nga Sheshi i Dëshmorëve dhe Rruga Unazore në Dragash. Në KAB, në qershor, ka qenë 106 mijë, tash është 53 mijë. Është viti i tretë që është i njëjti tender. Unë kisha pas qef – dje kryetarit i kam tregue – që në qytezën e Dragashit ku jetojmë na, edhe la Mehmet e profi e plot do këtu, nuk kemi ujë të pijshëm. Jo që s'kemi ujë të pijshëm, po nuk kemi ujë edhe për pastrimin e teshave ose për pastrimin e mjeteve në shpi. Unë e kisha pas një propozim, që në qoftë se nuk dalin këto pare, veç me fillue si qysh e keni marak një projekt dyvjeçar, me e ndërrue këtë, me e bo: Ndërrimi i ujësjellësit në qytezën e Dragashit. Se është me azbest të viteve '60-ta. Shkojmë më poshtë, numër 14: Hapja, trasimi dhe kubëzimi i rrugës Kuk-Kosavë. Është shumë për çudi, bëhet hapja, bëhet trasimi edhe bëhet kubëzimi menjëherë. Këto jeni ju superdrejtorët, jeni supersmarta dhe.. s'po e kuptoj unë, qysh mundet me u bo edhe hapja, edhe trasimi edhe kubëzimi me një projekt. Unë e di që na kemi bo, kemi qenë shumë në pushtet, e bojsh hapjen, e pushon pak, pushon dheu, ani bohet kubëzimi. Po fushata, herët ia keni nis zgjedhjeve, qysh e keni marak projekte dy-tri vjeçare. Në 21, e

kemi: Ndërtimi i kanalizimit edhe i kubëzimit në rrugën “Ograde” në fshatin Brrut, një projekt 900 euro. Me 900 euro, unë s’po mundi me e kuptue çfarë kanalizimi ndreqim, edhe çfarë kubëzimi bëhet me 900 euro. Kur ai person që ka me shkue me e marrë atë tenderin, ma shumë i kushton nafta me shkue tytje-tekne se me fitue diçka. Numër 32: Ndriçimi publik në qendër të fshatit Pllavë. Për çudi të Zotit, me 20 mijë euro, fshati i madh Pllavë s’di qysh bohet, kur në fshatin Rrenc që është më i vogël edhe keni qit projekt dyvjeçar 35 mijë euro. E qysh Pllavën me 20 mijë euro, qysh do të boni? Unë jam për me e bo, po shtoni edhe pak ma shumë pare, mos boni shumë projekte, bone një projekt, po bone një projekt të mirë. Pllava i ka 100 mijë, boni 50-60 mijë, bone mirë bre burra. Se vitin tjetër nuk jeni për me bo buxhetin e 2026-tës, se shkoni te shpia. Kështu që mos ia lini punët në gjys krejt fshatrave. Ndriçimi i fshatit Rrenc është projekt i 2023-të për 2024-tën, ka qenë 20 mijë euro, unë në këtë foltore ju kam thënë që para katër vite ka qenë 30 mijë euro, ju e keni qit në tender, s’më keni besue, se po fol Artani. Tash ju ka dalë problem, prej njëvjeçari e keni qit dyvjeçar. 20 mijë euro është për këtë vit, ndëra projekti kushton 35 mijë euro edhe del më 3 tetor. E kam pyet dje kryetarin, po dojnë qytetarët me e ditë, ku ka me i marrë kryetari 15 mijë euro për në mot me vazhdue projektin dyvjeçar. Stadiumi në fshatin Blaç – ju kujtohet shumë mirë, Sef kolega, ti je sportist i madh – me urgjencë kur i ndamë 50 mijë euro për Blaçin. Dy vite heshtët, tash i keni qit 70 mijë euro për në mot. A do të bëhet ai stadioni për me lujt “Opoja”, a jo? E kam edhe një propozim, ma kujtove mirë, e ke dhënë një propozim qetu për do perde – zahr s’po ju shkojsh për shtati edhe mo propozimet tua s’po t’i mbështesin, si të miat. A do ta propozosh këtë herë, a jo? Po dalim pak edhe kah pjesa e Gorës, se këta thojnë çka po të intereson, po na jemi qytetarë edhe kemi marrë vota prej Restelicës e më Zaplluxhe. Kryetari me atë drejtorin, mësuesin Behar, me drejtorin marakli të tenderave, në fshatin Radeshë për çudi i ka 400 shtëpi, i keni qit 70 mijë euro buxhet, ndërsa Krusheva s’i ka 100 shtëpi, ia keni qit 100 mijë euro. Unë s’po mundem me ju kuptue, kryetar, po kjo ka me ju dalë bumerang në zgjedhje, se është e pakapshme Radesha 70 mijë euro, e Krusheva 100 mijë euro. Je t’u i shkue për shtati atij drejtorit, po mos, se e ke gabim, po më vjen keq, se ka me të dënue qytetari vitin tjetër. Planifikimi i mençur – smart planifikim a ke qeky? Faleminderit!

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues, të nderuar delegatë, përfaqësues të OSBE-së, media, qytetarë, ju përshëndes të gjithëve! Sot mund të them se është një si seancë solemne, po diskutohet për një pikë shumë të rëndësishme, pika më e rëndësishme e vitit që do ta shqyrtojë Asambleja, që është Buxheti për vitin 2025. Është një buxhet të cilin e ka përgatit ekzekutivi i Komunës, duke u bazuar në nevojat e organeve komunale dhe kërkesat e qytetarëve të Komunës së Dragashit. Ju dëshiroj juve punë të mbare dhe suksese, shpresoj që pas miratimit të këtij buxheti, viti 2025 do të jetë një vit i sukseseve dhe investimeve kapitale, duke i plotësuar nevojat e qytetarëve të Komunës sonë. Ju

në rendin e ditës e keni marrë edhe materialin e Buxhetit për vitin 2025. Ndërkohë, sot ju kemi pru edhe disa ndryshime. Arsyeja e ndryshimeve është sepse jemi në kohën e hapjes së tenderëve dhe Zyra e Prokurimit na ka mundësue që të bëjmë bartjen e mjeteve, në mënyrë që të mos lëmë mjete diku mangu, ose diku tepër. Kështu që, këto propozime që i keni marrë, nga i njëjti fshat i kemi marrë nga një projekt i kemi qit në projektin tjetër, nuk kemi bo ndryshime, me ia marrë një fshati e me ia qit fshatit tjetër. Përveç te fshati Bresanë, ku ia kemi marrë Bresanës e i kemi qit në Kuklibeg. Kanë qenë aty 11 mijë, i kemi bo 16 mijë e diçka. Këto ndryshime i keni të shënuara me të zeza. Këtu te Bresana, te Arsimi dhe Shkenca, Numër 3, kanë qenë 35 mijë dhe janë hek ato, një pjesë janë bart te pozicioni i kubëzimit, edhe një pjesë janë bart në Kuklibeg. Gjithashtu, dua të ju sqaroj se në pozicionin “Investime të përbashkëta”, i kemi 200 mijë euro. Nga to, 150 mijë euro janë mjete që do të shfrytëzohen për komunitetin joshumicë, nuk janë mjete të shqiptarëve po janë mjete të cilat do të investohen në pjesën e Gorës. Ndërsa, 50 mijë euro mjete për bashkëfinancim me projekte nga ministritë, që do t’i shfrytëzojmë bashkë. Pse i kemi qit 150 mijë euro me komunitetin joshumicë, është kërkesë e tyre edhe unë e kam përkrahë si ekzekutiv. Arsyeja është sepse shumë ministri në vitin e ardhshëm dojnë me investue në pjesën e Gorës me bashkëfinancim Ministria e Kthimit dhe disa ministri tjera – mirëpo, ju siç e dini, çështja e rrymës në pjesën e Gorës, tensioni është shumë i ulët dhe linja e Restelicës është një linjë e cila ka nevojë me investue, dhe nëse KEDS mund të fillojë të investojë në atë anë, sigurisht që nëse bëhet me bashkëfinancim dhe nëse na lejon ligji dhe Qeveria, ne këto mjete të komunitetit joshumicë me shumë dëshirë kemi me i shfrytëzue në këtë drejtim. Gjithashtu dua të ju them se tash, pas ekspozesë time për buxhetin, sigurisht që do të ketë pyetje të ndryshme, kërkoj nga ju që, pasi t’i bëni pyetjet, t’i bëni në formë të shkruar, edhe kur të kryeni diskutimin me ma dhënë mu, e shënoni emrin kush është, në fund unë do të dal të gjithëve do t’ju jap përgjigje. I kisha lut delegatët në përgjithësi, në veçanti delegatët e pozitës, që në pikën eventuale të mos shkojnë te shpia, të rrijnë në Kuvend, nëse ka nevojë edhe deri në ora 18:00. Faleminderit!

Samidin Xheladini: Unë po i lutem kryesueses që të mos e shkel Rregulloren kur vij në pyetje unë, se gjithnjë e shkel Rregulloren kur vij në pyetje unë edhe s’ma jep fjalën. Në vazhdimësi nuk ma jep fjalën. Kjo le të jetë hera e fundit, unë jam delegat, i barabartë me të gjithë. Së pari deshta me e dhënë një përgjigje për zotërinë e nderuar, që del me tendenca. Ai mbrapa atje, jo ti, ma vonë ti. Nedžmidin Sejdlari. N’katund të vjetër, adet të ri, çka po do me na shit mend ai. Pika eventuale? Pikërisht vetë qata që po e lypin pikën eventuale, ikin vetë. Kurrë – qe sa jam në Asamble, veç një mungesë e kam, kurrë nuk shkoj e as jashtë nuk dal. E dini vetë. Pse ikni edhe lypni ju vetë kuorumin? E dyta: Te ky zotnia, respekt maksimal, e di mirë. Unë kur kam qenë në opozitë, tre mandate – e dinë edhe këta prezentë – që 70% të diskutimeve të përgjithshme të Kuvendit i kam bo unë. I kam adresue çështjet dhe i kam ndihmue pushtetit në formën time, qysh e kam pa unë të arsyeshme. Tash po vjen fjala, nuk i

thashë mos fol, i thashë fol sa të mundesh, po i jap hapësirë opozitës. Unë nuk po lypj fjalë, se jam në këtë legjislativë, për shumë arsye nuk po lypj fjalë, në mënyrë që me i dhënë hapësirë opozita me i adresue çështjet, sepse janë më të thirrur, se pushteti duhet me u vetëdijesue. Sa i përket propozimit, ju betohem – le të dalë një dëshmitar dhe të më thotë – që propozimin e Uran Halimit atëherë unanimisht e kemi përkrah. Unë pas asaj i kam bo do pyetje edhe i kam marrë do informata shumë të mira për mu personalisht, pikërisht për kerret. Prej zyrtarit përgjegjës. Dhe më ka tregue krejt detajet qysh është problemi. Mos t'i them ato që nuk duhet me i thënë. Unë e kam pa që propozimi yt, Uran, është me tendenca, nuk të vlen. Nuk është mirë. Të paargumentume, e ke me tendenca politike. Më vjen keq, nuk e mbroj askënd. Këto janë çështje që ju po i adresoni pa argumente. Kur janë prish kerrat, ti duhet me e dit. Shko pyet kur janë prish, kush i ka prish. Qetu janë prezent delegatët që e kanë akuzue ish-pushtetin për kerra që kanë pranue. Këta vetë e kanë ish-pushtetin, ish-kryetarin, ish-drejtorin, që kanë pranue kerra të vjetër. Këta po i ndreqin. Më vjen keq.

Uran Halimi: Ti Samidin, ma more fjalën, po të tolerova për shkak të moshës edhe e kam një simpati për ty, po s'e di pse je nervozue. Më thajë që kërkesën për formimin e Komisionit e kam tendencioze. Aspak nuk e argumentove. Po më vjen shumë keq që znj.kryesuese e tradhtoi këtë Kuvendin, na tradhtoi neve si delegatë, e veçanërisht juve të PDK-së që e keni votue me dorën e juaj. Më erdhi shumë çudi, kryetar, ke qenë shumë i bindur edhe, me njëfarë mënyre urdhërues, kur thajë duhet me e mbështet formimin e Komisionit edhe delegatët e pozitës në këtë rast. Për keqardhje jeni, më falni që po ju them, veç jeni duke e përdorë mënyrën më të ulët të mundshme. Sot votoni pro, e nesër kundër. Ne si përfaqësues të qytetarëve, duhet me pas pak parime përderisa kemi ardhë qetu. Përfaqësoni ata votues tuaj në mënyrë dinjitoze. Mos u boni bre kukulla, me u shfrytëzue, sot kështu e nesër ashtu, se nuk po më pëlqen. Unë kur e marr një vendim, ose një votë para dy vjete, të njëjtën e vazhdoj, aspak nuk trembem, asnjë troh nuk kërcënohem e shantazhohem, e hiç nuk e ndryshoj atë, kushedi çka me ndodhë. Ju e dini shumë mirë, kur kam thënë për diçka jo, kur jam konë ulur këtu në ulësen e znj.kryesuese, e kam mbajtur jo. Ju e dini shumë mirë që kur e keni bo keqpërdorimin, edhe pse kam qenë kryesues këtu, jau kam qit pikat e rendit të ditës, i kam akuzue edhe aspak nuk i kam mbështet, edhe përkundër kërcënimeve për shkarkim. E ju të nderuar delegatë, ju e dini çka boni e qysh veproni. Sa i përket Komisionit, normal që s'e boni se aty, përveç që janë diku prej periudhës prill-fundi i korrikut, janë diku 53,500 euro, domethënë diku 60 mijë euro që i kishit ble 6 xhipa, bon vaki me kilometrazh zero-zero. Tash vonë e pashë edhe një tender për ndërrimin e motorit të veturës së dializës. Hulumtova dhe pyeta nëpër automekanikë, më thanë që me ia ndërrue qasaj veturës motorin, maksimumi munden me kushtue 2 mijë euro kushton me ia ndërrue një motor një Ford Transitit 2013-tës. A e dish sa e ka pas vlerën ai tenderi? Në mirëmbajtje ma herët, ndërrimi i motorit të veturës ka kushtue 1 euro. Atëherë kur ju thojshin juve të PDK-së antifrizi 8 euro a sa ju ka kushtue, ndërrimi i motorit të veturës aty ka

kushtue 1 euro. Ndërsa sot, te ai tenderi i fundit, ndërrimi i motorit të qatij Fordit, që është shumë i vjetër ai, i 2013-tës, ka kushtue hiç ma pak se 6,485 euro. Shumë i sigurt jam që 6 mijë euro ai Fordi nuk i bon hiç. Samidin, 6,500 euro ia kanë ndërrue motorin veturës. Kjo është arsyeja pse s'po votohet Komisioni, o i nderum. Mos del këtu me thënë unë s'kam fakte, po ti e kie tendencioze. Hajde formoje Komisionin, ta shohim ku janë tendencat. Pse jo? Po ti kur ta propozojsh, nuk ta mbështesin, 1 votë e kie o Samidin. Në fakt, asnjë ndonjëherë s'e kie, se edhe atë tënden ta manipulojnë. Jo nuk jam duke e provokue, po s'po jep argumente. Me dalë me thënë e kie tendencioze, me zero bazë, kjo nuk është në rregull. Po kthehemi te buxheti. Unë edhe dje i thashë kryetarit të nderuar. Nëse ju kujtohet, të nderum delegatë edhe ju qytetarë që po na përcillni, në vitin e parë të qeverisjes, kryetar, i ke pas 27 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim sa i përket buxhetit. 27 vota, të ka kalue buxheti bon vaki me shumicë të votave, je konë prej komunave nashta edhe të vetme në Kosovë që i ke pas 27 vota. Sot ku i ke ato vota, kryetar? Çdo vendim është duke të kalue me zor, me një votë ma shumë, ose me atë të dyfishtën e kryesueses. A e dish pse? Se ke mendue edhe besue se nime e ke kamerë Zotin. E mas vitit të parë, asnjëherë s'të ka kalue mo buxheti ty me 27 vota pro, pa kundër edhe pa abstenime. Kam diskutue vazhdimisht, në vitin e dytë të qeverisjes, ka qenë viti 2022, menjëherë, edhe e kam pa që njëra prej kërkesave të qytetarëve të fshatit Blaç ka qenë rregullimi i ujëmbledhësve në Blaç. E pashë tenderin, kur shkova aty nalt – se unë lëvizi nëpër bjeshkë zakonisht, e kam qef kështu natyrën – e pashë që ujëmbledhësat veç janë lye me një ngjyrë, sa për me jau mshelë sytë qytetarëve. Edhe, prej foltores, edhe të kryesuesit, po edhe prej kësaj foltores vazhdimisht e kam akuzue këtë qeverisje për keqpërdorim të atij tenderi. Është kolona numër 6 në Listëne shpenzimeve kapitale të parapara për vitin 2025-2027. Kur e kam ngri zërin për këtë çështje, goxha ju ka ardhë siklet edhe prej atëherit ia keni nis me u trazue edhe me e mbledhë numrin për shkarkim të kryesuesit. Më ka ardhë shumë mirë që unë po shkarkohem pse para qytetarit e kam ngrit zërin për keqpërdorime të këtij buxheti, të kësaj qeverisjes edhe të këtij besimi që qytetari ia ka dhënë kryetarit të nderuar. Rregullimi i kaptazhëve të fshatit Blaç ka vazhdue prej vitit 2021, në parashikimin buxhetor të vitit 2022, ka vazhdue prapë në planifikimin buxhetor të vitit 2023, Samidin, po vazhdon prapë me qenë në planifikimin buxhetor 2024, 2025 edhe 2027. Pse, qe tri ose katër vjet po më duroni edhe s'po m'i bini këtu para qytetarëve, me argumentue çka është duke ndodhë edhe çka ka ndodhë më të. Nëse s'u keqpërdor, pse s'po bëhet? Pse s'u bo qe tri vjet? Vjet kam bo kërkesë për ndryshim të planifikimit të buxhetit, ka qenë një kolonë atë, për një rregullim te një lagje, “Ura e Haxhisë” aty që i themi. Është një qytetar atje që jeton, pa infrastrukturë as rrugore, as elemente tjera për jetë. Kryetari me shumë modesti e pranoi atë kërkesën edhe u votue buxheti me ndryshime. Në ndërkohë, ne si LVV morëm vendim që mos me u votue ai buxhet, edhe sinqerisht u ndjeva shumë keq, se kërkesa ime është pranue nga kryetari – për të cilën e falënderoj, nashta e kam falënderue edhe aëherë, nëse jo, qetash po e falënderoj – kërkesa jeme u pranue për ndryshimin ose

planifikimin e rregullimit të asaj pjese të fshatit. Ndërsa, sot jemi në fund të shtatorit edhe nuk kam pa asnjë punim të zhvilluar aty, përveç se një punim në mahallën tonë atje, në Mahallën Prifte është duke u shtruar një rrugë në pronë private. Sidoqoftë, nuk është bo as parkue në Rrugën “Shkëndija”, që është planifikuar në planifikim buxhetor të vitit të kaluar, nuk është bo as rregullimi i Rrugës së Shtavës atje, që kanë qenë të ndara diku 40 e diçka mijë euro, ose 34 mijë euro saktësisht. Edhe, nëse atëherë jam ndie keq pse s’e kam votue atë buxhetin, kur e pashë këtë Listën prapë me të njëjtat projekte, e pashë që s’ia ka vlejti edhe me u ndie keq, se s’ia kish vlejti edhe me e votue realisht. Sidoqoftë, e kemi dje që kemi diskutue në KPF, kryetari tha që ky planifikim buxhetor – edhe drejtori tha që është një planifikim i mençur i LDK-së. Është ai planifikimi i mençur veç i planifikuar edhe zero i realizuar, në shumicën e rasteve. Ky është planifikimi i mençur, drejtor, që mu më ka dhënë argumente edhe ju kam dërgue në hetuesi të krimeve ekonomike, për të cilën edhe jeni duke vazhduar me shkue me dhënë llogari atje. Qeky është planifikimi i juaj i mençur i porealizuar. Sa përqind është realizuar ky planifikimi. Se ju në letër gjithçka e keni të mirëplanifikuar. Mirëpo, prapa shpinës e keni të ndryshuar, të rregulluar edhe terezit kështu, veç për dosta edhe për aktivistë. Tash tha që nuk ka shkue në suficit. Drejtori i nderum dje tha s’ka shkue në suficit buxheti, domethënë u shfrytëzue. E sa i përket suficitit, unë vjet gjeta tenderin prej fillimit e në mbarim të vjedhur, edhe e çova në hetuesi të krimeve ekonomike. Komplet tenderi, veç për mos me shkue buxheti në suficit, drejtor, u zhduk pa u punue kurgjo hiç. Ku shkohet në suficit, kur ju i gjuani paret? Ose jau jepni dostave të juaj. S’ka suficit, se suficitin e merrni për veti. Mandej në KPF – fatmirësisht që s’ka pas kamera – mu edhe Artanit tha, ju të Blaçit tha edhe të Rrencit tha jeni njerëz provincialë. Drejtori për Ekonomi dhe Financa thotë jeni njerëz provincialë. Dilni tha pak, se keni mbet njerëz provincialë. Po na njerëz provincialë jemi, na s’une zgjedhim ku me jetue, qetu na ka caktue i madhi Zot ose fati ku me jetue. Jeni njerëz provincialë! Qeta njerëzit provincialë, drejtor, ty të kanë pru edhe ta kanë dhënë të drejtën me dalë qetu edhe me i quajt njerëz provincialë. Faleminderit shumë!

Nexhat Selaj: Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje kryetar, kolegë asambleistë, media dhe ju qytetarë! Pavarësisht se nuk desha të ndërlihem me parafolësit të cilët folën për Komisionin, po më takon që nja dy rreshta edhe unë t’i them. Kryetar, duhesh të jesh transparent dhe ta pranosh se në seancën e kaluar, para se të dalë në votim Komisioni, dole vetë prezent këtu edhe bone apel që të gjithë asambleistët ta votojnë, ta mbështesin. Edhe me sa po më kujtohet, ishim 24 të gjithë, edhe e votuam 24 asambleistë. Se çfarë ndodhi më vonë, po kam qef nga ju që të dilni dhe të na informoni, të na jepni informata pse nuk po e votoni atë Komision? Unë jam shumë i sigurt nga këto që t’i them, i kemi edhe mediat, janë edhe ato elektronike, se është më se e vërtetë kështu. Do të ndërlihem me parafolësin, i cili akuzoi PDK-në se e ka votue kryesuesen, e tash kjo na tradhtoi. Koleg i nderuar, gjithashtu të kam thënë, ju jeni ata të cilët e keni dhënë votën, ju jeni ata të cilët i keni lidhë duart, ju jeni ata të cilët jeni

përçafur, e keni prurë në pozitë LDK-në, dhe në këto të cilat ne i marrim këtu, gjithçka çka është e mirë, në interes të shtetit edhe në interes të Komunes, kjo Komunë, kjo qeverisje edhe kjo kryesuese do ta ketë votën e PDK-së. Andaj, duart larg nga PDK! Do të kaloj tek investimet. Pika 2, kryetar – Rregullimi i rrugëve në qytezën e Dragashit nga Sheshi i Dëshmorëve. Pak më parë Artani e diskutoi, unë po më duket se do të zërthej pak më tepër. Në Kornizën Afatmesme ishin 100 mijë euro, tash janë zvogëlue, janë 53 mijë euro. Jam shumë i sigurt, me atë që e tha Artani, jo që kemi bisedue por që kemi hall ne, ujin e kemi të papijshëm. Për ata banorë të cilët jetojnë në Dragash, i ke dëshmi të gjallë, po dëshmi më të gjallë se unë që jam banor këtu, që jetoj, edhe tan Mehmet si asambleist, si koleg, që rrimë bashkë pothuajse 20 e sa vjet, jo se nuk përdoret uji për pije, por as për amvisëri kur kemi reshje të shiut. Bizneset, në të shumtën e rasteve kur kemi reshje shiu dhe shkrirje të borës, detyrohen të blejnë ujë dhe të zhvillojnë veprimtarinë e vet. Nëse po të kujtohet, unë në vitin 2022 ta kam bo një kërkesë nga ky Kuvend që të investohet në ujësjellësin e Dragashit, pasi që ujësjellësi i takon – mos gabofsha – viteve të '50-ta dhe ata gypa janë të azbestit dhe sipas inxhinierëve janë kancerogjen. Kështu që, kishte qenë mirë që të është urgjent që investohet dhe të merren masat sa më parë për rregullimin e ujësjellësit në qytezën e Dragashit. Do të ndërlihem me pikën 26, kubëzimi i rrugëve në fshatin Zym, ceket edhe vendinga ku deri ku. Ishte edhe në vitin 2023, kryetar, i njëjti projekt. Nuk u realizua. Tash, s'po them mos ta rrejmë qytetarin, po mos ta gënjejme qytetarin, pak një fjalë më të butë, gjoja se po akuzohem se po jem pak i vrazhdë, mos ta gënjejme qytetarin se këtu i ka të ndara 35 mijë. Këto janë të ndara të vjetshme, të pashfrytëzueshme dhe të bartura në këtë vit. Ura në Qollopek, ishte 15 mijë euro, 8 mijë euro ishin investime të kryera ura, dhe mbeten edhe 7 mijë të tjera të investohen për hyrjen dhe daljen nga fshati, përtej fshatit, përtej lumit. Nuk e di a ke qenë në vendin e ngjarjes që të shofish se gjysma e fshatit është e bllokuar. Në kohën e verës nuk mund të kryhen punët verore, e në kohën e vjeshtës qytetarët mbeten edhe pa ngrohje edhe pa dru, pasi që pjesa më e madhe e pyllit për atë komunitet është nga pjesa e majtë e rrjedhës së lumit të Pllavës. Këto punime është dashtë të kryhen vjet, kryetar. Tash nuk i ke edhe në buxhetin 2025 Urën e Qollopekut, e cila është për kiamet. Do të ndërlihem tek pika e 30. Ku thuhet ndërtimi i stadionit në fshatin Pllavë – 50 mijë euro. Po ku shkuan paratë të cilat u ndanë vitin e kaluar dhe sa punime u kryen vitin e kaluar? Unë nuk po muj me marrë me mend që ishte projekt i cili duhet të fillojë edhe të mbarojë, atje vetëm është gropue. Nga njëra anë prishja e asaj natyre gjatë rrëmimit, dhe nga ana tjetër hedhja e dheut në anën tjetër, prapë prishje e ambientit. Do të ndalem më së shumti do të flas, se këtu po më dhëm, se këtu po marr rrogë edhe po punoj. Te 'akademia' që po e quajmë ne, e keni quejt edhe ju, çfarë po ndodh në Shkollën "Ruzhdi Berisha"? A nuk është turp, kryetar, të ndahen 40 mijë euro për një gjimnaz, që unë e quaj fabrikë e cila prodhon intelektualë dhe i shet Kosovës. Ju po më duket se po doni me e shkatërrue atë fabrikë. Me 40 mijë euro investime në shkollën "Ruzhdi Berisha", e me 200-300 mijë euro investime nëpër

fshatra tjerë – nuk po përmendi komunitete ku po shkojnë ka 200 mijë, 300 mijë euro, ju sigurisht e dini edhe asambleistët e dinë, unë po kam frikë nga votuesit, s'po due të përmendi. Veç nga 200 mijë nëpër fshatra me nga 70-80-100 nxënës, e të ndahen 40 mijë euro për Gjimnazin, ky është...mas turpit, nuk di a ka fjalë tjetër. E filluat aneksin, unë ju thashë ishte projekt dyvjeçar, ju akoma më keq e thelluet veten, thaje njëvjeçar. Unë e kam ditë se është 2023-2024, ju thatë është 2023. Shkoi 2023-ta, shkoi 2024-ta, aneksi ka mbet vetëm me 4 apo 5 shtylla. Kishte me qenë mirë ta hapni edhe një tender tjetër, bare të vini t'i mbuloni ato gërmadha që janë hap aty, që e keni hup edhe pamjen e Gjimnazit. Ndërkohë do të ndërlihem edhe me tjera. Faleminderit!

Samidin Xheladini: Unë e di që kryetari nuk ia jep përgjigjen, respekt zotëri, mu më preki diçka, jo si subjekt po si delegat edhe si person e kësaj Komune. Thaje 40 mijë euro për Gjimnazin, i thaje kryetarit turp për ju që i keni nda 40 mijë euro në akademinë e dijës. Unë po due me dalë me ta dhënë përgjigjen. A s'është turp për ju që i keni nda 3 milionë euro, 3 milionë e gjys atje edhe e keni lënë kolibe? A nuk është turp për ju a, a keni debatue ndonjëherë për pushtetin e juaj, për gabimet katastrofale, fatale, që kreu buxhetin e ka çue për një shkollë atje edhe atë shkollën e shfrytëzon sot Komuna për magazina e të ngjashme. Edhe ti vetë, për shembull, po çojsh. A ju vjen turp? A keni debatue ndonjëherë në partinë tuaj, në subjektin tuaj, unë s'e kam thënë atëherë edhe s'kam folë. Mos e keqpërdorni, unë nuk lejoj me më thënë turp për ju kryetar, se është përfaqësuesi më i dejë, edhe më i mirë, edhe më i zoti, edhe më i aftë në Kosovë. Nuk lejoj!

Nexhat Selaj: Nuk pata diçka me shtue, veç një përgjigje shumë të shkurtë, ta Samidin. Kur përdori fjalën 'turp', ta kesh veç të qartë... ne këtu jemi tu e zhvillue një politikë edhe gjithçka çka flitet, flitet në kuadër të partisë të cilën e udhëheq, si kryetar që udhëheq këtë qeverisje. Në aspektin profesional edhe individual, çfarëdo respekti, s'kam çka shtoj unë. Ne flasim për udhëheqjen edhe për ndarje të mjeteve të cilat janë bërë për Gjimnazin. Edhe të jesh shumë i qartë, mos del këtu veç me thënë po dal me folë. Unë akuzoj për ato para të cilat janë ndarë për Gjimnazin, duhet të jetë turp për këtë qeverisje. Këtë qeverisje e udhëheq kryetari, nuk e udhëheqi unë. Sa i përket asaj që thaje për 3 milionë e gjys, atë shumë mirë e dish se sa përquind kanë investue shoqatat joqeveritare dhe sa përquind ka investue Komuna. Atë shumë mirë e dish që janë investue vetëm 20%. Mos u mundo me dalë, me shit këtu mend edhe politikë, ta Samidin, po më vjen marre me të thënë. E para, edhe e dyta: e ke pas të drejtën me dalë me folë këtu kur ka qenë ajo parti në pozitë. A s'ke pas aftësi të shprehurit, apo nuk ke desht, apo ke pas rezervë, mu po më vjen keq me folë. Unë flas për këtë qeverisje e cila është duke udhëhequr. Për qeverisjet të cilat kanë udhëheq deri më tani, nëse ka udhëheq mirë ajo ka udhëheq 12 vite, kur nuk ka udhëheq mirë i ka lëshue vend pozitës, e cila jeni ju sot edhe po qeverisni më mirë. Aty ku qeverisin, ta kesh shumë të qartë, ky Nexhat Selaj, nëse nuk e njohish mirë, të bardhës nuk mund t'i them e zezë. Veç, të zezës, kryet me ma këput nuk i them e bardhë. Aty ku keni punue unë nuk mund të akuzoj,

vetëm jap fjalë dhuratë edhe fjalë miradije. Aty ku nuk është e mirë, do ta dëgjosh 100 herë fjalën jo të mirë.

Edin Kurt: Pershendetje te gjithëve. Me intereson sa i përket fshatit Brod, kubëzimi e rrugëve, rregullimin e perroit, Gjonoec, me intereson rregullimi, mendoj se do ta perfundoj ate projekt, pra pse duhet te ndajme fonde per vitin e ardhshem edhe kete vit . Unë jam duke pritur për një përgjigje. Çfarë më intereson tjetër, ndërtimi i një shtëpie turistike në Rudinën në fshatin Brod, më intereson se si do të duket ajo shtëpi, kush do ta përdorë, kush do të jetë përgjegjës për të, kush do ta mirëmbajë. Unë kërkoj përgjigje.

Agron Gashi: Përshëndetje kryetar, znj.kryesuese dhe ju kolegë të tjerë! Unë vetëm pak, duke parë pasqyrën e investimeve kapitale për vitin 2025, te pika 37 shoh: “Asfaltimi i rrugës Brrut – Zgatar dhe rregullimi i rrugëve të asfaltuara në Kuk, Kosavë, Pllajnik, Kapre, Brrut, Brezne, Buqe, Pllavë, Rrenc dhe Shajne. Por shuma totale e kësaj kap prej 7,497 euro. Duke u bazuar se janë në pyetje 12 fshatra, dhe rregullimi i këtyre rrugëve kërkon një kosto më të lartë, sepse është shumë tejet e ulët, unë kisha kërkuar të bëhet rishikimi edhe një herë i kësaj pike këtu, sepse po ta përpjestosh, i bie që çdo fshat për afërsisht me 50 euro të bëhet rregullimi i rrugëve. Duke marrë parasysh që në fshatin Brezne është intervenuar me kanalizim, rruga është deformuar, është prerë asfalti, dhe për t’i rregulluar ato rrugë, tani kërkojnë mjete të konsiderueshme. Dhe mund të them plotësisht se kjo shumë nuk mjafton, vetëm për fshatin Brezne nuk është e mjaftueshme. Por, 12 fshatra të tërë, unë të them të drejtën, e pashë si shumë tejet të ulët dhe po kërkoj të bëhet rishikimi i kësaj pike. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Të nderuar qytetarë, e shihni vetë se qeveria është në panik dhe se ka një frikë të madhe, duke pasur parasysh se komisioni, i cili u mbështeten vetë në seancën e kaluar, u rrënuar sot, duke filluar me Kryesuesen dhe duke vazhduar. Vetë kryetari kërkoi në seancën e kaluar që të formohet një komision, që ne të gjithë e mbështesim, sot e kanë shembur, se ku i kanë shpenzuar paratë e destinuar për mirëmbajtjen e automjeteve komunale. Nuk e di çfarë perktimi keni, e pyeta nese e kishit lexuar, ishte përgjigje e diskutueshme. Nuk thashë që nuk e dini, por a e keni lexuar buxhetin. Duke lexuar buxhetin, shoh se na mungojnë paratë në Gorë. Në bazë të informacioneve që kemi marrë, në muajt e kaluar se gjysma e drejtorëve dhe këshilltarëve janë përmes rrjeteve sociale, kemi marrë informacion se në Gorë na takojnë 1.740.000 euro për investime kapitale, të cilat i ka siguruar deputete e Kuvendit të Kosovës. Zonja Duda Balje. Ku janë ato para unë nuk i shoh askund ato para. Unë isha i lumtur për këtë. U gëzova kur pashë presidentin duke e dekoruar me emblemat e komunës. Ishte në faqen e komunës. Keni parashikuar 125 mijë euro për kubëzim në Brod, a do të jenë kubëza nga floriri. Çdo vit shkojnë në kubëza 80, 100, 15 mijë euro, ku janë ato kubëza. Asnjë kubëza nuk është. Pse po mburreni dhe pse po i shpërdoroni paratë e këtyre qytetarëve? Pse nuk keni projekte konkrete siç keni projekte konkrete në Opoje. Në Opoje, ju e dini saktësisht se cila rrugë është kubëzuar. Në Gorë, vetëm

rruga filani thuhet se kushton 125 mijë euro. Pse nuk keni projekte specifike të rregulluara paraprakisht. Ju lini hapësirë që paratë të mos shpenzohen dhe ato para të ndahen në ndonjë ribalancim buxhetor dhe kështu të na reduktohen. Për impiantin e lumit në fshatin Radeshë keni buxhetuar 485 mijë euro, 126 mijë euro nga mjetet vetanake. Unë kam informacione se ju keni marrë një peticion nga qytetarët para një viti dhe Fejsal Haliloviq e di këtë, se ata nuk pajtohen me marrjen e lumit. Ju duhet të shkoni dhe të flisni me ata njerëz dhe të gjeni një zgjidhje adekuate. Nuk kam nevojë të shkruaj fjalimet e mia, flas nga koka ime. Ky debat po shkon në drejtim të gabuar, falë vëllait tuaj. Nuk është mirë për ty, madje më bën mirë kur më sulmon, do të më vinte shumë keq nëse më lavdëronte. Unë po ju pyes drejtpërdrejt për implantin, nëse do t'i përgjigjeni peticionit dhe nëse do ta diskutoni atë peticion, të cilët po kërkojnë një zgjidhje nga e cila do të përfitojnë të gjithë qytetarët e kësaj komune.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Para se me e marrë fjalën Driton Ademi, në qoftë se nuk është e disponimit me vazhdue Asambleja, se edhe unë po ndihem keq, ose do ta vazhdojmë Asamblenë, ose unë kështu nuk mundem me vazhdue. Asnjë asambleist, asnjë drejtor, prej vendit tash nuk e lejoj, përndryshe e mbylli seancën. Ju kisha lut për herë të fundit! Ata që e kanë marrë fjalën deri tash, pasi të dalë kryetari edhe dy minuta kanë me i pas, nuk kam me lejue më. Përgatitni mirë çka po delni me folë. Prej vendit, prej këtij momenti, në qoftë se flet dikush, unë jam e detyruar me e thirrë edhe me e qit jashtë. Unë due me m'shkuë Asambleja mirë. Ju kisha lut edhe një herë, mos të bëhet këtu pazar, prej atjehit e atje. Na kemi qenë shumë herë këtu. Sejdilari e merr fjalën për buxhetin, del më fol për Komisionin, kur unë në fillim e thashë që do ta tregoj në pikën eventuale pse s'e kam qit pikë të rendit të ditës. Kuptone, s' duhet diçka për me e kuptue.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë! Atëherë, unë do të filloj pak me kryetarin. Në seancën e qershorit, në Kornizën Afatmesme... kryesuese, unë po e shoh që nuk është disponimi, ma mirë po marrim pauzë deri në ora 12:30.

Arijeta Skeraj: Nuk do të lejoj, kryetari është në sallë. Vazhdo, Driton!

Driton Ademi: Atëherë, po filloj prej KAB-it. Kryetar, shumë mirë e dish që në qershor të kam lavdue që vjet ke fillue me mbajtjen e dëgjimeve buxhetore nëpër fshatra. Por, këtë vit nuk e ke realizue këtë. Edhe nuk e di a presish diçka prej Grantit qeveritar në qoftë se nuk e ke realizue dëgjimin buxhetor nëpër fshatra. Atëherë, unë i kam tri kërkesa prej fshatit Bresanë, pasi nuk e keni bo dëgjimin buxhetor në çdo fshat, ashtu siç kërkohet me ligj. Një kërkesë e fshatit është mbledhja e ujërave atmosferikë, prej Urës së Madhe që shkon deri te Trafa. Përafërsisht, qysh e kam folë me këtë se nuk e di saktë, përafërsisht mund me kushtue rreth 23 mijë euro mbledhja e ujërave atmosferikë. Pika e dytë është pastrimi i lumit në fshatin Bresanë, prej fillimit të fshatit e deri në krye – 70 mijë euro. Edhe pika e tretë: Mure mbrojtëse të betonit në fshatin Bresanë. Unë kërkoj që te pika e 8-të – mos gabofsha – të shtohen këto, pika 9, pika 10 edhe 11. Jo të jetë me këtë emërtim të buxhetit, që është 288 mijë euro,

sot që e prut në seancë. Domethënë, këto pare që janë të ndamë – 23 mijë, 70 mijë, me këto tri kërkesa të shtohen si pika të rendit të ditës. Pikë 10, 11 edhe 12. Arsyeja e kësaj është se vitin e kaluar unë i kam bo tri kërkesa. Prej tri kërkesave të vitit të kaluar – rregullimi i shtrojave të reshetskave nuk u bo. Hala nuk është bo, ka ardhë shtatori e nuk është bo. Ndërtim i murit mbrojtës në Mahallën e Donajve, e ke planifikue sivjet. Kryetar, qe dy vjet, unë vjet e kam lyp këtë, për sivjet me u krye ajo, ti e ke planifikue për 2025-tën. Edhe, ndërtimi i trotuarit te Ura e Madhe e kam kërkuë, trotuari ngjit me Urën. Nuk ka fillue as kjo. Nëse nuk hyjnë në buxhet këto, me pikat unë qysh po i kërkoj, 9, 10 edhe 11, këto tri kërkesa, unë nuk e votoj këtë buxhet. Se vitin e kaluar, tri kërkesat e mia, hala asnjëra kërkesë nuk është realizue. Unë nuk e kam pa edhe që janë në proces të tenderimit. Pres që këto kërkesa me hy. Këto janë kërkesa të qytetaëve të cilët vetë i kanë kërkuë. E dish shumë mirë, se të dy jemi të të njëjtit fshat, që kërkesa më e madhe është pastrimi i lumit. Edhe ujërat atmosferikë, që vetë ec kah ajo rrugë – te Rruga e Varrezave – edhe besoj që është kërkesa më urgjente se kubëzimi i rrugëve. Edhe një pyetje, kryetar, te qe ky kubëzimi i rrugëve. Unë e kam edhe buxhetin e vitit 2023 për 2024. Shumica që i kam nxjerrë unë, nga 69 pika që janë, projeksione që i ke bo, 30 i ke të njëjta si vitin e kaluar, veç shumat të ndërruara. Prej arsim, shkencë, kulturë, nga nëntë, tri i ke të njëjta si vitin e kaluar. Veç shumat që jau ke ndërrue. Po folim veç për në Bresanë: Kubëzimi i rrugëve, Rruga “Luftëtarët e Lirisë”, Rruga e Zgatarit dhe Rruga e Imamajve, dhe rregullimi i Parkut. Kryetar, qetu në Bresanë nuk e ke bo as rregullimin e “Luftëtarëve të Lirisë”, kubëzim, as të Zgatarit dhe as të Imamajve. Deri më sot që po foli, në shtator, nuk është bo asnjë rrugë. Nëse është bo ndonjë rrugë dytësore, atëherë është tjetër send, po qeto rrugët që i ke planifikue nuk janë bo. Kryesuese, unë kërkoj që këto tri pika të futen në pikat 9, 10 dhe 11, nëse ka mundësi. Faleminderit!

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Në lidhje me buxhetin e planifikuar për vitin 2025, nëse e shohim Listën e shpenzimeve kapitale, që qeverisja komunale e ka nda buxhetin ashtu qysh e ka planifikuar, shohim që është një buxhet që përfshin kubëzim, ndërtim i murit mbrojtës, kubëzim, ndërtim i murit mbrojtës... 80% e buxhetit shpenzohet në kubëzim dhe ndërtim të mureve mbrojtëse, e pak në investime të tjera. Do të ndërlihem me investimet të cilat do të bëhen në fshatin Zgatar. Është pjesa e murit mbrojtës te Kuji i Mullinit dhe muri mbrojtës dhe kubëzimi Te Serdani. Është planifikue të kubëzohet edhe një rrugë që familjen Sallahu me pjesën tjetër të fshatit. Përveç këtyre investimeve, nuk po shoh që kemi diçka investime tjera në fshatin Zgatar. Nuk keni planifikue kurgjo. Nuk po e shoh planifikim tenderin e pompave të ujit, kryetar, tender i vitit të kaluar, i dështuar për arsye të shpalljes në fundvit nga ana juaj e atij tenderi. Mjetet kanë qenë të ndara, 8 mijë euro, ka shkue në suficit ai buxhet. Nuk po e shoh të planifikuar për këtë vit që do të ketë investime në pompat e ujit në fshatin Zgatar. E dimë shumë mirë që fshati Zgatar është një ndër fshatrat më problematike për ujë të pijes, për arsye se furnizohet me pompa, uji bartet përmes pompave. Nuk po e shoh që e ke planifikue me investue

aty asnjë cent. Nuk po e shoh që ke planifikue me investue asnjë cent në turizëm në fshatin Zgatar. Kam bërë kërkesë që të ndërhyhet në këmbshhtëpizat në pjesën e Gjermanit, ku frekuentohet prej një numri të madh të qytetarëve. Janë për keqardhje ajo pjesë e atyre këmbshhtëpizave. Janë tërësisht të dëmtuara, nuk kemi planifikue asnjë cent. Nuk po e shoh asnjë cent të ndarë për largimin e deponisë ilegale, të cilën kam bo kërkesë që të largohet ajo deponi. Atë kërkesë e kishit shqyrtue, kishit shkue e kishit vendos një tabelë informuese për moshedhje të mbeturinave. Asnjë cent i ndarë për largimin e atyre mbeturinave. Rrugët të cilat kanë filluë këtë vit edhe vitin e kaluar, rrugë të cilat kanë mbet përgjys, është rruga në familjen Murati, është investim i vitit të kaluar. Është mbet përgjys. Ka fillue investimi diku tjetër. Nuk është vazhduë ajo rrugë, investimi ka kalue diku tjetër. Rrugë që janë të filluara, të lënë përgjys, projekte të filluar, të lëna përgjys. Ka edhe shumë rrugë të tjera, mos të flas për kualitet të ndërtimit, të punimve. Kualiteti është jashtëzakonisht i dobët. Unë nuk e di inxhinierët e Komunës, inspektorët e Komunës, a dalin edhe me i pa edhe qysh e bëjnë pranimin e atyre punëve. Ma freskët e kemi shtrimin e rrugës në Brrut me asfalt, në Kosavë me asfalt. Secili që ka kalue në atë rrugë, e sheh që është kualitet jashtëzakonisht i dobët i ndërtimit. Jashtëzakonisht i dobët! Harxhohet buxhet komunal, kualiteti është zero. Për mendimin tim është zero. Nuk është me iu hedh hi syve qytetarëve, e me ju thënë që na jau kemi bo. Bone, po bone qysh duhet, investo, po investo qysh duhet. Është për keqardhje qysh harxhohet buxheti komunal në këso projekte që janë jashtëzakonisht ndërtim shumë, shumë i dobët. Po e shoh që kryetari e ka planifikue në vitin 2025 – është vit elektoral – edhe buxhetin e ka planifikue elektoral. Kubëzim, ndërtim i murit mbrojtës. Kaq. Faleminderit!

Suada Bajrami: I nderuar kryetar, kryesuese, kolegë asambleistë! Unë deshta me u ndërlidhë këtu me buxhetin, te korniza 37: Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Shajne. Një kërkesë që ka ardhë prej banorëve të fshatit Shajne, është të futet edhe renovimi i ujit të pijshëm, pasi që është kryer instalimi komplet i ujit prej bjeshkës, ka nevojë në disa zona dhe në disa vende të bëhet edhe renovimi i gypave dhe i ujit, për të qenë uji i pijshëm. Dhe, një kërkesë tjetër të cilën ia parashtrajmë kryetarit. Ne si Grup i Grave Asambleiste në bashkëpunim me kryesuesen dhe zyrtaren për Barazi Gjinore, parashtrajmë edhe një kërkesë. Duke e parë numri i grave me kancer po shtohet dita-ditës fatkeqësisht, ne kërkojmë nga kryetari për subvencionimin e grave në vlerë 500 euro. Secila grua që diagnostifikohet – shpresojmë të ketë pak raste, po sidoqoftë, duke pas parasysh se kërkesat dhe nevojat e grave janë të shumta, ndoshta kjo vlerë është shumë simbolike, por së paku të mundohemi që t'i përkrahim dhe t'i mbështetim me këtë shumë. Faleminderit!

Pajtesa Berisha: Përshëndetje të nderuar asambleiste, kolegë, kryetar dhe ju të gjithë të pranishëm! Me kërkesë të banorëve të fshatit Buqe, duke e ditur pozitën gjeografike të fshatit, pothuajse çdo vit investohet në rrjetin e kanalizimit. Dhe këtu, në këtë planifikim buxhetor, nuk po e shoh që është i parashikuar kanalizimi, por vetëm kubëzimi. Andaj, kërkoj që të rritet buxheti për fshatin Buqe dhe

pjesa e mbetur e kanalizimit të finalizohet. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Kryetari tha që një prej seancave dhe materialeve më të rëndësishme që e diskutojmë ne si asambleistë dhe marrim vendim është ky material i sotit, pra buxheti. Çkado që na ka ardhur nga ekzekutivi, ata mendojnë që është i arsyeshëm, ne i japim propozimet tona ku mendojmë që duhet të ndryshohen. Dhe pastaj merret vendimi në fund, natyrisht, nëse e pranojmë si të ndryshuar apo kështu si na ka ardhur nga ekzekutivi. Ajo që u diskutua deri më tani nga të gjithë asambleistët, kolegët e mi, u diskutua vetëm për projektet apo investimet kapitale të cilat do të kryhen në vitin 2025 – që janë planifikuar të kryhen, nuk dihet nëse kryhen apo jo. Me ato premtimet të cilat i japin gjithmonë kryetarit para ardhjes dhe marrjes së mandatit, gjithmmonë dihet se në Komunën tonë të gjithë kryetarët si premtim të tyrë kryesor e kanë, e kam thënë në të gjitha buxhetet e mëparshme, që janë blegtoria dhe bujqësia, natyrisht ndikim të madh ka edhe turizmi në Komunën e Dragashit, për hapje të vende të reja të punës, për rritje ekonomike të Komunës. Ajo që më befaso i mu ishte Neni 4, shpërndarja e mjeteve të buxhetit të Komunës së Dragashit sipas programeve buxhetore që është bërë dhe planifikuar nga ana e Drejtorisë së Financave. Po shoh këtu, Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural – 195 mijë janë ndarë për këtë Drejtori. Në vitet e kaluara e di që ka qenë më i lartë buxheti, në krahasim me këtë vit. Një përparim e kishit bo te subvencionet, po nuk e di ato si do të ndahen. Kisha pas dëshirë që përgjigjen në pyetjet e mia të ma jap drejtori i Financave, pasi që besoj se është adekuat, nëse ju kryetar nuk keni mundësi të ma jepni. Nëse keni, mund të ma jepni edhe ju, s'është problem. Një rritje e kemi tek Shërbimet Publike – 530 mijë, në krahasim me vitin e kaluar që ka qenë shumë më i ulët. Andaj, i nderuar kryetar, apo i nderuar drejtor, cilido që të më jepni përgjigje. Tek Shërbimet Publike, mos rastësisht keni bërë planifikimin e pagesës së ndriçimit publik të atyre fshatrave që deri më tani nuk janë të kyçur në pagesë? Më japish përgjigje nëse është ky planifikim. Ndërsa sa i përket bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, gjithashtu kisha pas dëshirë të më japësh përgjigje pse është ulur buxheti në këtë drejtori, kur dihet se në këtë drejtori duhet çdo vit të rritet buxheti dhe jo të ulet. Pse e keni bërë një planifikim të tillë, që ta ulni? Tjetra për të cilën unë desha të diskutoj, është edhe çështja e projekteve kapitale të cilat vetëm më parë i prekën disa asambleistë. Pse është bërë bartja e një pjese të madhe të projekteve nga viti i kaluar në këtë vit. I njëjti, të njëjtat shkrime, të njëjtat projekte. Pak ka ndryshime në shumat që i keni planifikue. Ato projekte nuk kanë përfundue në vitin e kaluar, apo keni bo ndryshime gjatë rrugëtimit të projekteve këtë vit? Për këtë përgjigje, besoj edhe kryetari mundën me ma dhënë, se i ka këto informacione. Dhe për fshatin Kuk, edhe vitin e kaluar unë kam qenë kundër buxhetit, vetëm për shkak të fshatit Kuk, sepse ndarja e buxhetit në vitin e kaluar nuk ka qenë adekuat dhe nuk ka qenë i duhuri për fshatin Kuk. Edhe këtë vit është ndarë një buxhet i cili për mu, po besoj që edhe për kolegun tim nga fshati Kuk, nuk është i arsyeshëm. Nëse mbetet kjo ndarje buxhetore për fshatin Kuk, unë natyrisht prapë jam kundër këtij buxheti, sepse kërkoj që fshati Kuk të ketë së paku

edhe 30-40 mijë më tepër, në krahasim me këtë që e keni planifikue ju këtë vit. I nderuar drejtor i Financave, kisha kërkuar edhe këtë vit, edhe pse e di se e ke problem që ta mbështetësh, se nuk e ke ndoshta mbështetjen edhe të kryetarit, po edhe të asambleistëve në pozitë. Pse nuk ke shkue te Lista e shpenzimeve kapitale për vitin 2025 që ta ndihmoni bujqësinë dhe fermerët në këtë drejtim? E din ti shumë mirë që shumica e komunave në Kosovë e bëjnë përmes projekteve kapitale. Sepse, përmes subvencionimeve është, pothuajse për një pjesë të madhe të komunave, i ka të ulëta dhe s'mund me ndikue aq shumë me subvencione. Por, përmes investimeve kapitale e ke këtë mundësi. Ti i din ankesat e fermerëve, nevojat e tyre. Është dashtë të shkohet këtë vit që të ketë 200-300 mijë euro t'i ketë ndarë që t'i ndihmojmë fermerët, me makineri apo kërkesa të ndryshme që ata i kanë. Edhe mos të shkojmë gjithmonë siç po shkojmë. E kam thënë edhe vitin e kaluar, edhe në vitin 2022, kjo është copy-paste, si na keni thënë neve, e PDK-së, vetëm me kubëzime. Kubëzimet i kena krye na, ju po e vazhdoni prapë. Nuk ndikon në zhvillim ekonomik, nuk ndikon në hapje të vendeve të reja të punës qeqy projekt-buxhet. Nëse ndikon, ma thuaj drejtor i Financave, që ky buxhet ka me ndikue në rritje të ekonomisë, të Komunës dhe në hapjen e vendeve të reja të punës. Munden me ndikue pak te kompanitë e qyteteve tjera të cilat marrin projekte, i bijnë punëtorët e vet, e bijnë makinerinë. Te ata pak munden me ndikue, nja 4-5 muaj, kryejnë punime edhe ecin teposhtë. Po jo vallahe për ne këtu, jo! Na iku rinia, u krye rinia. Tash p na ik familja, komplet, edhe pas dy viteve, e kam thënë edhe vitin e kaluar, pas dy viteve po tash ka mbet një vit, vitin e ardhshëm në tetor i kena zgjedhjet, na veç duhet me dalë me i mbledhë do pleq qaty që kanë me mbet nëpër rrugë, edhe me iu thënë o burrë a po më votojsh bre, se s'ke kujt i merr mo votë. Ju lutem, duhet ta ndryshoni këtë Listë të projekteve kapitale. Ky buxhet, kjo ndarje, kjo Listë e shpenzimeve kapitale, nuk po e përsëris më edhe një herë, se e thashë disa herë, për mu nuk është e arsyeshme dhe nuk do ta votoj, nëse nuk merren parasysh ato kërkesat e mia të cilat ishin për fshatin Kuk. Të rritet buxheti dhe, natyrisht, nëse e sheh të arsyeshme drejtori, së bashku me kryetarin t'i ndajnë edhe atë shumën që e kërkoja, 200-300 mijë për fermerët. Ju falemnderit!

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, ju falënderoj për kontributin tuaj dhe diskutimet e juaja për buxhetin. Thashë edhe në fillim, është projekti më i rëndësishëm i këti viti edhe është pika më e rëndësishme e Asamblesë Komunale për këtë vit, sepse po votohet për buxhetin e vitit 2025. Unë prita nga ju që të m'i bini ato pyetjet që i keni bërë me shkrim, por përveç Dritonit që m'i dha, tjerit nuk m'i dhatë. Po më vjen keq që unë duhet ta them, që qëllimi i juaj pse nuk m'i dhatë pyetjet, unë mund ta keqkuptoj, se ju mundeni pastaj të dilni këtu dhe të bëni propagandë, shpifje, në mënyrë që opinionin ta dëgjojë, unë pastaj të mos jem në gjendje me iu përgjigje këtyre edhe të kujtojnë opinionin që këto çka po i thoni janë të vërteta. Por megjithatë, unë mbajta shënime. Atëherë, te Uran Halimi, ndërrimi i motorit që e përmendi – 6 mijë euro. Ndërrimi i motorit të atij automjeti është bërë në baza ligjore dhe në bazë të të gjitha procedurave të prokurimit publik. Ti nëse ke dyshime, kërko qasje në dokumente,

merre lëndën edhe çoje në prokurori pa problem. Sa i përket Komisionit, do të përgjigjem në pikën eventuale. ‘Kamerë e kam Zotin’, shumë po e përmendish këtë, nuk është kulturë kjo, por megjithatë, unë kam thënë e kam kamerë Zotin për korrupsion, edhe për hajni edhe për vjedhje. Deri më tani, edhe pse ke çue lëndë – po thuesh vetë që ke çue lëndë në prokurori – asnjë aktakuzë nuk është ngrit. Edhe atë projektin që e paske imagjinue, që një projekt qenka paguar e s’është kërkund, ndaj atij projekti nuk është ngrit aktakuzë edhe është pezullue kjo. Nuk ka të dhëna, asnjë projekt të cilin ti e ke imagjinue. Ujëmbledhësi në fshatin Blaç, ta kam dhënë edhe dje përgjigjen, është në procedurë të tenderimit, ka qenë edhe para dy viteve. Nuk është krye, nuk është punue, edhe pse ka qenë titulli i projektit ‘ujëmbledhësi’, nuk është punue, nuk është pague asgjë për ujëmbledhësat. Nëse nuk beson, shko merri dokumentat. Ura e Haxhisë është në tender, këtë vit kryhet. Profi Nexh ka bërë disa pyetje. Për Komisionin do të përgjigjem në eventuale, nëse e shoh që është e nevojshme përgjigja ime, do ta them. Pozicioni numër 2, te uji, siç e dini, ujin në Dragash e menaxhon një kompani regjionale. Është kompani publike, nuk është në kompetencë të Komunës. Por megjithatë, ne vitin e kaluar kemi ndarë një sasi të caktuar të mjeteve, ku bashkë me mjetet e “Hidroregjionit” kemi ndërhyrë në ujësjellësin e Dragashit edhe, pas asaj ndërhyrjeje, ka pas një përmirësim të dukshëm të kualitetit të ujit të pijshëm në qytezën e Dragashit. Mirëpo, në ujë jemi duke investuar afër 3.5 milionë euro dhe presim që vitin e ardhshëm të zgjidhet problemi i ujit, sepse në këtë ujin që po investojmë na do të lidhet edhe qyteza e Dragashit. Për rrugën që e keni pa, janë paraparë edhe këtë vit të bëhet kubëzime, vitin e ardhshëm në buxhet. Po, ka qenë vjet kjo rrugë që të kryhet, por ka qenë trasimi, ne e kemi shkruar trasimi edhe kubëzimi në mënyrë që nëse arrijmë ta bëjmë kubëzimin, e kishim bo. Mirëpo, mjetet nuk kanë mjaftue, është bërë vetëm trasimi. Tash, me kërkesë të qytetarëve të cilët kanë qenë te unë, kanë kërkue që të bëhet kubëzimi, edhe kubëzimi do të kryhet në vitin 2025. Ura, ajo ura nuk po kushton sa e kemi planifikue, po kushton diku afër 40 mijë euro, për arsye se kohë pas kohe, vit pas viti, kemi pas kërkesa të qytetarëve për mure, nalt, poshtë, anash etj. Kështu që, ura këtë vit përfundon në tërësi, është në proces të tenderimit. Edhe ura përfundon në fund të këtij viti, bile më mirë sesa që ka qenë e planifikuar. Për shkollën që thatë keni ndarë vetëm 40 mijë euro. Ju në një seancë të kaluar më keni akuzue se është projekt dyvjeçar. Unë e kam gjet dokumentin që është projekt njëvjeçar, jo dyvjeçar. Ky projekt është dashtë të përfundojë më 15.11.2023. Janë ndarë 61 mijë euro për me e përfundue aneksin e Gjimnazit. Janë harxhue 21 mijë, kanë mbet edhe 40 mijë pa harxhue. Për fat të mirë, këto mjete nuk kanë humb, ato janë përdorë për pagesën e kontratës kolektive. Këtë vit, ne kemi planifikuar që për vitin e ardhshëm me ato 40 mijë euro me e përfundue aneksin e Gjimnazit. Unë e kam konsultuar DKA-në, kam vërejt se kërkesa tjera për renovimin e Gjimnazit nuk ka pas, përveç lyerjes së sallës së fizkulturës. Ne në sallën e Edukatës Fizike do të bëjmë sivjet disa renovime dhe investime. Unë thashë që ka qenë e planifikuar me u përfundue, janë ndarë 61 mijë euro. Nuk është përfundue, për arsye se ka qenë një

kompani e papërgjegjshme. E ka marrë punën, e ke pa edhe vetë qysh i ka zhague punët dhe s'ka mujt me i përfundue. Por, fati që nuk i kemi humb mjetet. Tash, nuk po them që është bërë mirë, nuk është bërë me dëshirën tonë, mirëpo këso raste ngjajnë. Por ne atë do ta përfundojmë se i kemi ndarë mjetet. Në fshatin Pllavë është projekt dyvjeçar, nuk kemi mujt me e bo, kanë me u krye edhe sivjet disa punime, vitin e ardhshëm kryhet krejt, i kemi ndarë mjetet 50 mijë euro për këtë drejtim. Te Rruga e Brrutit janë diku afër 7,400 euro të ndara. Ky ka qenë emri i projektit të kaluar, kur është bërë asfaltimi i asaj pjese, edhe kodi, kështu që ne i kemi borxh. Ato janë borxh, nuk do të investohet në asnjërin prej këtyre fshatrave, por janë borxh që kanë mbet nga viti i kaluar, kur u krye ky asfaltimi. Dhe ne është dashtë patjetër me e shkure kodin e projektit edhe në bazë të atij kodi me e bo pagesën e borxhit, dhe i kemi paraparë këto mjete me i pague vitin e ardhshëm. Sa i përket intervenimit në rrugën e Breznes, ai intervenim do të bëhet sivjet, kemi paraparë në projektin ku po bëhen këto asfaltimet në disa fshatra tjerë nga Granti i Performancës. Z.Sejdilar ka bërë pyetje, peticionin e fshatit Radeshë, e di, e kam marrë, e kam parë. Por ne e kemi edhe një peticion të mëhershëm ku qytetarët e Radeshës kanë pranue që ky projekt që është nis më 2012-tën të vazhdojë, edhe ata kanë pranue që ky projekt të kryhet. E ne, në bazë të atij pëlqimi që e kanë dhënë qytetarët e Radeshës, që atë pëlqim e ka marrë qeveria e kaluar. Ajo nuk kishte mundur t'i fillojë procedurat e tenderimit pa e pas pëlqimin e fshatit. Pëlqimi i fshatit ekziston, po ju jeni një person i cili do që këtë Komunë, që është shumë stabile, ta bësh një destabilizim ku marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe ndërnacionale... ti je njeri i paguar të bësh një destabilizim. Marrëdhëniet ndërnjerëzore, ndërnacionale janë jashtëzakonisht të mira, jemi shembull në Kosovë. Nuk po më pëlqen, edhe disa herë ta kam përmend, mos prek në marrëdhëniet shumë të mira, vëllazërore që i kemi. Ky nuk është vetëm kontribut i imi, por është edhe i qeverive të kaluara. Mos na prish këtë harmoni që e kemi ne këtu! Kubëzat në Brod, nëse ke dyshim e ke prokurorinë, nuk është problem hiç. Ne e dimë që çdo gjë që është bërë me tender, është investuar, është kryer. Ndërsa, ti nëse dyshon, ka rrugë tjera, mundesh me e vërtetue. Driton, te mbledhja e ujërave atmosferikë, ti vitin e kaluar e ke propozue, ai projekt është krye. E kemi përfundue, ne s'kemi pas nevojë me e pru te ura, po e kemi marrë atë ujin ku po grumbullohet atje. S'kemi nevojë një kilometër kubëza me e prish asfaltin, kur na atë ujin e kemi orientuar në një drejtim tjetër edhe ai ujë mo nuk vjen teposhtë. Inxhinierat e kanë bo projektin, unë nuk jam inxhinier. Edhe ne e shohim, nëse është ashtu qysh po thojnë, na prapë jemi këtu, e rregullojmë. Muret mbrojtëse janë të parapame, do të bëhen, po këto janë projekte dyvjeçare. Disa punë kanë fillue tash, janë duke u bo kubëzimet, edhe disa punë kanë me u krye vitin e ardhshëm, kështu që vitin e ardhshëm, në tërësi ato propozimet që i ke dhënë ti kanë me u realizue. Tash është punë e jotja, a e votojsh a s'e votojsh buxhetin, është çështje personale. Pastrimi nuk është i planifikuar, po ne mendojmë që me fillue këtë vit me e bo pastrimin. Jetmir Ajdini ka vërejtje që veç po shkohet me kubëzime e mure mbrojtëse. Po këto janë kërkesat e qytetarëve, edhe ti vetë ke propozue mur

mbrojtës vitin e kaluar, edhe e ke propozue edhe emrin cilin mur mbrojtës. Edhe ke propozue tash, familjes Murati, ne ia kemi fillue asaj familjes Murati me ia shtrua rrugën. Është shtrua pjesa më e madhe e rrugës. Nuk ka qenë propozim i yti, propozimi yt ka qenë vetëm muri mbrojtës. Por atë ne do ta kryejmë, se është në projekt. Nëse nuk kryhet, vijsh e flasish me mu. Është e planifikuar, tenderi është i nënshkruar dhe kanë filluar punimet. Është projekt dyvjeçar. Te deponia ilegale, ke të drejtë, kemi çdokund. Hapin e parë e kemi bo, kemi vendos afër 50 tabela nëpër të gjithë territorin e Komunës së Dragashit. Ato të cilat kanë qenë më herët nuk kanë qenë të mjaftueshme, kemi vu edhe tabela tjera. Është mirë qytetarët me u vetëdijesue, mos me hedh mo. Ne do të bëjmë përpjekje që këto mbeturinat që janë hedhur, me një tender ta bëjmë pastrimin, edhe vitin e ardhshëm, nëse fitojmë, me Grantine Performancës, do ta aktivizojmë njërën prje deponive të mbetjeve të ngurta. Nuk janë paraparë, se nuk ka mjete. Ne tash i kemi paraparë edhe 30 mijë euro me e bo shpronësimin e tokës për shkollën që është ndërtue pas luftës. Kjo Asamble ka votue me ia pague Bashkësisë Islame atë pjesën e tokës, kështu që neve na ka ardhë vlerësimi, 130 e diçka mijë euro duhet me pague. Jemi marrë vesh me Bashkësinë Islame për tri vite me e pague. Vitin e parë do ta paguajmë 30 mijë euro. Edhe ato janë investime në Zgatar. Për pompat i bëjmë me Mallra dhe Shërbime. Suada e ka bo një propozim i cili nuk prek në buxhet, kërkon që vetëm të plotësohet emri i projektit, të shtohet edhe renovimi i ujës-jellësit. Andaj, unë si kryetar propozoj që, krahas atyre propozimeve që i kam dhënë unë, me këto ndryshimet që janë bo në emra, të hyn edhe ky propozim i Suada Bajramit, që vetëm të plotësohet emri, masi s'po prek në buxhet. Edhe sa i përket propozimit tjetër, atë propozim unë jam zotuar që do ta bëj me subvencione. Pajtesa, po ashtu është propozim i njëjtë i Pajtesës për fshatin Buqe, që të plotësohet emri i projektit edhe ndërtimi i asaj pjesës së kanalizimit që ka mbet pa u krye. Unë propozoj që edhe ky propozim të futet, sepse nuk implikon në buxhet. Shpetim Hajredini, rritje e shërbimeve publike në 530 mijë euro. Ne këtë e kemi bo, e kemi bo edhe vitin e kaluar por nuk na ka pranuar Qeveria, na i ka kthye prapë. Këtë vit besoj që do të na i pranojë. E kemi bo këtë rritje, sepse duam që gjithë fshatrat të cilat kanë ndriçim publik, të futen në sistemin e pagesës nga ana e Komunës. Një pjesë e madhe, gati gjysma janë fut, u kërkoj ndjesë fshatrave të cilët deri në këtë moment nuk kemi mund, po vitin e ardhshëm të gjithë fshatrat do të futen – vetëm është një kusht, që duhet ta bien kërkesën për pagesë dhe ta bien faturën zero-zero. Te uji investohet sivjet, janë mjetet e ndara, edhe nga buxheti që e kemi miratuar vitin e kaluar, investohet sivjet. Ke thënë që është zvogëlue buxheti për bujqësi dhe blegtori. Ju e dini që tash Pylltaria mo nuk është kompetencë e Komunës, dhe e gjithë pasuria e Komunës sa i përket pyjeve është marrë nga Qeveria qendrore. Buxheti është i njëjtë, subvencionet janë të njëjta, nuk kemi bo zvogëlim. Ju propozuat që edhe me i nda 200-300 mijë euro për bujqësi e blegori, për blerjen e pajisjeve nga investimet kapitale. Nuk kemi të drejtë! Nëse ti mujsh me na gjet një mundësi zgjidhje, që mujm me bo këtë, në buxhetin e vitit 2025, kur ta miratojmë për vitin 2026, e futim në buxhet edhe

këtë e bëjmë. Këto mund të bëhen vetëm me subvencione edhe bashkëfinancim. Në infrastrukturë mujm unë thashë, po ky tha me ble pajisje për blegtorë. Po ne në infrastrukturë jemi t'u e çue rrugët për bjeshkë që po i çojmë. Shumica dërmuese janë për blegtorë, edhe janë për grumbullimin e bimëve mjekuese, frutave të malit etj. Unë propozoj që Asambleja të miratojë këtë buxhet. I mbeta borxh një asambleistit nga JGP-ja, i cili bëri një pyetje për shtëpinë malore. Shtëpi malore ne nuk do të ndreqim vetëm në Brod, po kemi ndreq edhe në fshatra tjera. Do ta përgatitim një Rregullore që do ta miratojë Asambleja, për mënyrën e shfrytëzimit të atyre shtëpive. Ato janë prona të Komunës, nuk janë prona private. Sepse po investon Komuna në vendin e vet edhe me mjete të vetat. Do ta bëjmë një Rregullore të shfrytëzimit të tyre, për të mirën e qytetarëve, rinisë dhe njerëzve të cilët duan të dalin. Sa i përket atij projektit që thashë kanalizim, që thajë i ujërave atmosferikë, ai është projekt dyvjeçar. Këto janë mjete të parapara për vitin e ardhshëm që kanë me u pague. Mirë është që është krye, por janë mjete të cilat duhet të paguhen për vitin e ardhshëm. Faleminderit! Kërkoj nga asambleistët që, buxhetin që e kanë marrë si rend dite, gjithashtu edhe propozimet që i dhashë unë si kryetar, i keni me vija të nënvizume me të zezë, edhe këto dy propozimet e dy asambleistëve që i dhanë – pasi nuk ka implikime buxhetore, të hyjnë si pika të miratuara dhe të miratohet buxheti. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryesuese! Me z.Nexhat flasim në eventuale. Po ndërlihem, meqenëse i përkasim buxhetit, po ndërlihem me përgjigjet që na i dha kryetari neve. Tha që për atë tenderin e ndërrimit të motorit është gjithaçka në rregull me letra. Edhe kur është gjithçka në rregull me letra, është edhe në rregull kështu, moralisht, sipas kryetarit. Me letra ju jeni në rregull, edhe te kaptazhet me letra jeni në rregull, kryetar, mirëpo edhe qytetari më i thjeshtë e di që ndërrimi i motorit të një veturës së vitit 2013 nuk kushton 6,500 euro. U dashtë me iu ndërrue me qato pare nja 5 a 6 veturave motori. Qet muhabet e kam unë, i nderumi Samidin. Unë paguhem për me e bo qet muhabet këtu. Na jemi qetu për me e bo qet muhabet. Na ka pru qytetari për me e bo qet muhabet. Jo Urani, se Samidini është duke më ndërpre, e jo unë Samidinin. Po më ngo, normal që ke me m'ngue se unë të ngova ty deri tash. Po unë nuk e di pse je këtu prezent ti, non-stop t'u i pengue secilit delegat. Po hiç mos ngo, del jashtë kur të foli unë, nëse nuk të pëlqej, çka kam me të bo. Po më vjen shumë keq, Samidin, që je qashtu, ama duhet me ngue, o vëlla. Po një ditë në muaj, s'ka lidhje, këto janë çështje që më preokupojnë, ti i ke do çështje tjera. Po vazhdojmë, sidoqoftë. Tha që kam thënë kamera e Zotit sa i përket korrupsionit. Domethënë, më ka thënë kryetari e kam kamerë Zotin, veç për korrupsion. Po për nepotizëm, kryetar, a e ke kamerë Zotin? Ne si VV e kemi ngrit një çështje të punësimeve tua, të Kabinetit tënd. Ti qetu m'i përmende, bre kryetar, çka të bëj unë, pse s'i laje në eventuale ti me m'i përmend.

Arijeta Skeraj: Uran, t'kisha lut edhe një herë, në eventuale do t'i flasësh këto. Këtu ke replikë për qato që ia ke bo kryetarit. Të lutem, në pikën eventuale a keni dashtë? Tasj katër orë kemi me nejt në pikën eventuale. Shfrynu edhe çka të doni boni. Të lutem, mos ma ndërprej seancën. Edhe një minutë

po ta jap kohë, pse të ndërhyta.

Uran Halimi: Okej, znj.Skeraj, mudohnu me m'kuptue, edhe ti kryetar. Unë mbajta shënime çka fole ti pak më përpara. Po t'i kishe lënë përgjigjet në eventuale, ne kishim folë në eventuale. Nëse e shohish të arsyeshme, unë po i lë këto në eventuale edhe po i diskutojmë në eventuale. Okej, ne si LVV kemi mendue që ky është buxhet i ndarë më së shumti në kubëzime të oborreve. Edhe, shumica e tyre në baza partiake, se na jetojmë në atë vend edhe i shohim që po hapen dyert e oborreve edhe po shtrohen kubëza brenda oborreve sidomos të aktivistëve partiakë. Unë e kam pa që edhe në kohë të fushatës i kemi akuzue partitë e kalume për kubëza, kubëza, kubëza. Më pëlqeu ai debati i Shpetimit, ku tha që cili është ndikimi në ngritje të ekonomisë. Cila është ngritja ekonomike, në bazë të qatij planifikimit buxhetor të mençur që e keni bo ju. Është zero! Shumë sinqerisht po them, është zero se s'ka. Te subvencionit i bujqve, është ide shumë e qëlluar. Bravo, Shpetim! Faleminderit shumë!

Driton Ademi: Edhe një herë, kryetar, po të ndërlidhem. Te pika e ujëmbledhësave, unë e kam pa që ish duke u punue atje nalt, te Pishat, po qekjo që ecin fëmijët, rruga kryesore. Rrugë magjistrale është, fëmijët po shkojnë shkollë qaty. Qeky është projekt ma madhor me e bo, ta kanë lyp edhe vjet në dëgjim buxhetor, shumë mirë e dish. U konë Sefa me atë takim. E kanë lyp qytetarët, nuk e ke shti në buxhet vitin e kaluar. Është mirë këtë projekt me e shti në buxhet. Edhe pastrimin e lumit, vetë e ke pa te mahalla jote qysh ka shpërthye gjatë vërshimeve. Këto janë projektet që janë më madhore se kubëzim me ju bo dikujt nëpër shpia. Deshta me u ndërlidhë te dy pika të cilat i ke pa, se parëz harrova. Ndërtimi i pllakës së kulmit dhe renovimi i shkollës fillore. A e dish kur është qeky? Shaban Shabani kur ka qenë në 2021-tën e ka shti këtë. Domethënë, është duke vazhdue edhe në 2025-tën. Cila pllakë ka me u bo, kryetar, a ka mundësi me e ditë. As shkolla nuk e di cila pllakë. Qeky ndërtimi i pllakës së kulmit dhe renovimi i shkollës fillore, unë e di që u bo qaj kulmi edhe ka fillue, se janë me tri ndërrime shkolla. Ndërtimi i këndit të lojërave, kubëzim, demolim i shkollës së vjetër "28 Nëntori" në fshatin Bresanë. Në takimin e parë masi ke ardhë kryetar, e di shumë mirë se jem konë në mbledhje bashkë me ty, edhe jemi konë në mbështetje për qeto demolimet edhe me u lirue vendet, edhe të kemi kërkue që me e pru kadastrin, ku është vendi, pjesa e Komunës ose e shkollës, ku i takon, kemi kërkue me e pru kadastrin edhe me shkue deri në pikat ku i takojnë shkollës. Edhe prapë po të kërkuj prej këtu, te qeto pika është mirë me e pru kadastrin edhe me i vu pikat tamam mirë. Veç edhe një pyetje qetu: Po e bojsh këndin e lojërave, po e ke çue pazarin, o kryetar, atje. Qysh do t'ia bojsh, e ke çue pazarin aty e do të vonojsh kënd të lojërave në Pazar. Këtë s'po e kuptoj unë. Faleminderit!

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë, unë deshta me u ndërlidhë me çështjen e buxhetit. Në qoftë se gjërat bëhen me tendencë, janë shumë të dëmshme. Ne jemi organi më i lartë i Komunës. Ekzekutivi, kryetari i Komunës vjen këtu para Kuvendit, edhe na i paraqet në bazë të ligjit ato që ne duhet t'i miratojmë. Buxheti është pika kyçe e Asamblesë Komunale edhe mandatit tonë. Kur të vjen raporti i

harxhimeve buxhetore, mos e votoni 100%! Po buxhetin mos me e votue, përgjegjësi kulminante është e Asamblesë. Pse? Se me ligj, kryetari ka të drejtë – në qoftë se Asambleja Komunale nuk e miraton buxhetin – me i çue Asamblenë në zgjedhje. Të lutem, Driton Ademi, qe po ta jap argumentin. Salim Jonuzi, kur ka qenë kryetar, unë kam qenë asambleist, edhe zoja ka qenë aty prezent, e di shumë mirë, edhe do tjerë nashta kanë qenë, Salim Jonuzi, pikërisht anëtarëve të partisë së vet, kur s’e kanë votue buxhetin për interesa lokale, partiake e çka di unë aty, Salimi këtu ka dalë na kë thënë: Në qoftë se nuk e votoni buxhetin ju sot, unë pres edhe ju çoj në zgjedhje. Unë përherë e kam votue, me vetëkënaqësi buxhetin, edhe pse kam qenë në opozitë, po e kam votue se ai buxhet i popullit është, s’është as i Salim Jonuzit, as i Shaban Shabanit, as i Bexhet Xheladinit. Buxheti është investim kryekëput i qytetarëve. Unë po ju them kështu: Kryetari, qeveria, na bien neve buxhetin, na me e miratue. Ne kemi të drejtë me propozue. Na kemi të drejtë me lyp, po jo interesa të ngushta, qysh po e shoh, parciale, familjare, dajallarë e katunarë. Kurrë nuk jam çue me lyp në mënyrë parciale, për shembull për Bresanën investime. Ky zotëri Driton Ademi na ka bo një problem, se po kushtëzon, po e vazhdon atë traditën. Ta ka pranue ky, unë kurrë nuk ta kisha pranuar. Ky ta ka panuë në shenjë respekti, s’e di pse. Një shpi malore atje në Bresanë. Për çka në Bresanë shpi malore? 500 shpia malore i kanë ndreq qytetarët me paret e veta, ti po çohesh shpi malore atje. Na kemi shpi malore atje, krejt kanë shpi malore atje. Ambulanta jeme është hotel me pesë yje. Nuk e kam personale, unë po ndërhyj do sende me t’kanalizue, jo me të qit prej shinave. Përkundrazi, po due me t’i sinjalizue do sende, se nuk mundet krej njeriu me i ditë, unë këtë e quaj si mbështetje. Pasha Zotin nuk e kam provokim, edhe binduni. Jo pse është kryetar vëllai jem. Duhet me pas kujdes, se qytetari qat fjalinë qatje e mban në mend. Edhe në qoftë se bëjmë ndonjë gabim pa bazë, edhe neve si Asamble na bjen hise. Edhe në qoftë se unë bëj gabim, Asambleja Komunale jam. Bashkë me ju. Faleminderit!

Agron Gashi: Unë me vëmendje e dëgjova kolegun tim Dritonin që bëri kërkesat e tij. E drejtë legjitime, i zgjedhur nga populli dhe është e drejtë legjitime të kërkossh. Por, mbi të gjitha, është mirë nganjëherë që nga paslufta deri më ditët e sotit, t’i drejtohesh Zyrës së Prokurimit dhe të merr statistika, të dhëna, se ç’është investuar në atë fshat tuaj. Është mund të thuash një metropol, po ta krahasosh me fshatrat tjerë. Ke shtëpi të kulturës, ke shkolla të renovuara, ke sallë sportive mbi gjysmë milion euro. Ke një infrastrukturë që po ta krahasosh me fshatrat tjerë është dukshëm më ndryshe. Po mos të harrojmë, paratë janë të qytetarëve, paratë janë të 35 fshatrave të cilat kanë hise në ato 4.5 milionë euro. E tëra që dua të them, të dalësh të kërkossh, por gjithmonë duhet të llogaritet, në pikën 8 janë 288 mijë euro, të cilat janë shumë e konsiderueshme. Mund ta keni kryetarin, po nuk mund t’i keni të gjitha mjetet me i delegue në Bresanë. Ndryshimet janë drastikisht të mëdha. Është mirë të dalësh atje, me kolegun tuaj, të pish një kafe me e pa fshatin Brezne, a i ka ai fshat atje apo jo. Atje nuk ke shtëpi të kulturës, atje nuk ke çerdhe të fëmijëve, atje nuk ke fushë sporti, atje nuk ke ujë, atje nuk ke kanalizim,

atje nuk ke të gjitha gjërat. Dhe të dalësh të kërkosh pandërprerë mjete është e padrejtë, sepse përpjestimi shkon me 35 fshatra, i nderuari z.Driton. Faleminderit shumë!

Nedžmidin Sejdilar: Besoj se keni kundër peticion banorëve të fshatit Radeshë për ujësjellës. Unë ju besoj absolutisht. Dhe se e keni pëlqimin e qytetarëve të fshatit Radeshë, por meqë ju ka ardhur edhe një peticion, dërgoni përgjigje të dokumentuar atyre njerëzve. Dërgojini një përgjigje, atë peticion dhe do të jemi mirë. Të nderuar qytetarë të fshatit Radeshë, të cilët më keni kontaktuar deri më tani për ta zgjidhur këtë çështje, sot bashkë me kryetarin e kemi zgjidhur në mënyrën më të mirë, që do të thotë se ju vetë e keni dhënë lumin. Kështu tha kryetari i komunës, do t'jua dorëzojë në përgjigjen e peticionit. Nuk është dashur të vish në foltore për të thënë që po marr para, kjo ishte e ulët nga ana jote, sepse e di që kur ofrove para, ia dolët mbanë me mua. Në takimin tonë të parë, negocimin, kur më kërkuat të vi me ju në koalicion, kur përdornit të gjitha atutë, bashkë me zotin Kolloni në restorantin Meka, tavolina e tretë nga e majta, u përpoqët me para dhe dështoi. Kryetar, kam dhënë paratë e mia private për të ardhur këtu dhe për të luftuar për interesat e atyre qytetarëve që më kanë mbështetur në këtë. Nuk po bëj asgjë që nuk u kam premtuar atyre njerëzve. Ishte totalisht e ulët nga ana juaj të theksoni disa gjëra të tilla, sepse kushdo që më njeh e di që nuk më interesojnë paratë. Ju u përpoqët, dështove. Ka tentuar të më blejë edhe Qamil Kolloni duke thënë se do të ketë diçka edhe për ty, hajde me LDK-në. Citoj se këto ishin fjalët e Qamil Kollonit. Nuk mund të jetë kështu, zotëri. Sejdillarët nuk blehen. Jemi parimorë, nuk e shesim veten, as besimin e qytetarëve, as besimin e askujt.

Shpetim Hajredini: I nderuar kryetar, ti gjithmonë e ke potencuar në fjalimet tua, nëse ke vullnet bën gjithçka. Po edhe ti, nëse ke dëshirë, thaje që ligji nuk e lejon përmes projekteve kapitale. Por përmes Drejtorisë së Bujqësisë jam i bindur që e lejon. S'ka kush që ia ndalon përmes Drejtorisë së Bujqësisë, me i ndihmue fermerët me ato që kanë nevojë. Ndërsa, sa i përket investimeve kapitale, ke mundësi prapë të bësh diçka të mirë për ta. T'ua shtrosh kubëzat nga rruga kryesore deri tek fermat. Nëse ke ti vullnet, kryetar, mujsh ta bëjsh edhe në formën tjetër, përmes projekteve kapitale mund t'ua shtrosh rrugën nga rruga kryesore deri tek fermat. Absolutisht këtë të drejtë e ke edhe s'ta ndalon askush. Mbështetjen tonë do ta kishit pas pa, dyshim. Dhe opsonin tjetër, të tregova, e ke direkt prej drejtorisë së bujqësisë që t'i ndihmosh fermerët. Por, në momentin që nuk ekziston vullneti, dëshira, nuk ke dëshirë për ta kryer një gjë të tillë, atëherë ka arsye. Por, ju e dini mirë që ata kanë nevojë për ju edhe ju duhet t'u gjendeni pranë atyre. Ndërsa, sa i përket çështjes së buxhetit për ndarjen për fshatin Kuk, ma përmende diçka ujin, por unë për ujin s'di nëse bon pyetje. Tek e fundit, edhe Resuli e di, edhe ta Kapllan, që unë nuk ndërhyj në projektet e fshatit Kuk, por për shumën po. Se thashë, kjo shumë që është bërë, kjo ndarje për fshatin Kuk nuk është adekuate. Dhe pikërisht kjo është arsyeja që vitin e kaluar nuk e kam mbështet buxhetin, prapë këtë vit nuk do ta mbështes vetëm për këtë arsye. Ju faleminderit!

Bexhet Xheladini: Unë vetëm Dritoni desha t'i përgjigjem. Ndërtimi i pllakës. Është emri i projektit i cili e ka kodin e vet. Ju keni ndarë mjete sa me ia vu njëfarë kulmi atij stadionit. Jo me e ndërtue si sallë të Edukatës Fizike. Këto mjete – janë 21 mijë e diçka euro, janë borxh i cili duhet të paguhet nga i njëjti projekt me të njëjtin emër, me të njëjtin kod. Kompanisë që i ka krye punimet i kemi mbet borxh, ajo e ka çue lëndën në përmbarrim. Kur kam dëgjue për këtë, e kam thirrë, kam bisedue, ai e ka tërheq, e unë i kam garantuar që në buxhetin e vitit të ardhshëm i parashohim këto mjete që ia kemi borxh, edhe i kemi paraparë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! Besoj se i keni marrë të gjitha përgjigjet nga kryetari. Driton Ademi që i ka pas tri propozime, të triat kryetari ia ka sqarue. Suada Bajrami që e pat për rrjetin e ujit në fshatin Shajne, kryetari tha që do të futet kjo dhe do ta fusim. Edhe Pajtesa për rrjetin e kanalizimit në fshatin Buqe. Atëherë, të nderuar anëtarë të Kuvendit, e qesim në votim Propozim-vendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027, me ndryshimet dhe plotësimet. Driton Ademi, ty për të triat propozimet tua të ka dhënë kryetari sqarim që janë në procedurë e sipër. Kush është pro miratimit të Buxhetit të Komunës së Dragashit? A ka kundër? A ka abstenim? Me 14 vota pro, 6 kundër dhe 3 abstenim, miratohet buxheti i Komunës së Dragashit për vitin 2025. Le ta gëzojë e gjithë Komuna e Dragashit! Atëherë, dalim në pauzë, në ora 13:30 kthehem në seancë! Faleminderit!

Atëherë, po fillojmë me punën e Kuvendit të Komunës së Dragashit. Pasi i miratuam dy pikat, fillojmë te pika e tretë: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së Komunës P-70604038-00244-4 ZK Shajne, me sipërfaqe 12500m/2. E hapi diskutimin! A do dikush me e marrë fjalën?

Bexhet Xheladini: Të nderuar asambleistë, lidhur me pikën e rendit të ditës që e lexoi kryesuesja, dua të ju njoftoj se janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim të kësaj toke për qëllim të zgjerimit të aktivitetit biznesor. Kështu që, në dorën tuaj është që të votoni apo jo, dhe ta autorizoni kryetarin e Komunës që të lidhë marrëveshje kontraktuale me kompaninë e cila e ka fitue të drejtën për me e shfrytëzue këtë tokë. Nëse ka dikush me pyet sa jam këtu në foltore, munden me pyet. Siç e dini, është hera e tretë që Asambleja merret me këtë çështje. E para është shqyrtimi i kërkesës, e dyta është formimi i Komisionit, edhe Asambleja ka prurë vendim që Qeveria Komunale dhe organet e saj të shpallin tenderin për këtë pikë të rendit të ditës. Janë ndjekur të gjitha procedurat, Komisioni e ka marrë vendimin, është shpallë në tabelën e shpalljeve, Vendimi është botuar në listën ku botohen vendimet e Kuvendit Komunal. Kështu që, është në dorën tuaj tash ta merrni një vendim. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Duke u nisur nga parimi se që nga qeveria e kaluar ka qenë e propozuar një qendër industriale që të hapet në Mejdan të Shajnes, edhe duke e parë të arsyeshme se bizneset kanë filluar të zgjerohen – unë me plot kuptim të fjalës e kuptova kryetarin që e ka një dëshirë të mirë për zgjerim dhe

për dhënie në shfrytëzim. Edhe po më vjen shumë mirë që po i japim të drejtë bizneseve, pavarësisht se kujt apo çka i takon. Në emër të PDK-së, të Grupit Pralamentar, ne do ta mbështesim, jo vetëm këtë dhënie në shfrytëzim. Gjithmonë duke iu referuar ligjit, pasi që kryetari na njoftoi se me ligj janë kryer të gjitha procedurat gjyqësore. Jo vetëm këtij biznesi, por të gjithë bizneset të cilat, nga kjo foltore, i apeloj të gjitha bizneset në atë qendër industriale, të cilat i plotësojnë kushtet në aspektin ligjor, kanë të drejtë të zhvillojnë veprimtaritë biznesore. Edhe një herë, në emër të PDK-së do ta mbështesim këtë propozim. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, kërkoj nga Asambleja që ta mbështesë këtë vendim dhe të autorizojë kryetarin që të lidhë marrëveshje për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë. Atëherë, e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 16 vota pro, zero kundër dhe 3 abstenime, e miratojmë këtë pikë të rendit të ditës. Atëherë, kalojmë në pikën e fundit, eventuale.

Nexhat Selaj: Kryetar, drejtorin e DKA-së nuk po e shoh këtu. Nëse më lejohet që unë kërkesën ta parashtoj për drejtorin e DKA-së, të cilin nuk po e shoh këtu. Andaj, do të shpresoj se nga ekzekutivi, kryesisht nga kryetari, do të pranohet disa nga ato kërkesat edhe përgjigjet duhet të m'i jap dikush. Po filloj nga e para, tek punësimet, kryetar. Çfarë po ndodh me këto konkurse të cilat vazhdimisht po na krijojnë huti në fillimin e vitit shkollor? Kemi në disa shkolla ku mësimi klasor ka filluar me vonesë nëpër disa lëndë, e pikërisht nëpër ato konkurse të cilat kemi maksimumin, kemi shtatë arsimtarë të cilët mungojnë deri më tani. Shtrohet një pyetje: Kaluan një muaj mësim, unë vetë jam mësimdhënës dhe minimumi i orëve të ndara kemi nga dy orë në javë. Kaluan katër javë, janë tetë orë të humbura. Nuk po flas për ato lëndët lëndore që i kanë edhe nga tri ora në javë, nëse i llogarisim edhe ato dalin nga 20 orë. Për Gjymnaz dhe lëndor llogaritet edhe shkolla e ulët e lartë. Edhe e ulëta e larta aty në përgjithësi, kryetar. Çfarë po ndodh me këto vonesa të konkurseve? E dyta është pak për keqardhje, e keni pranuar një kërkesë për transfer të një mësimdhënësi, i cili është mësimdhënës 15-vjeçar dhe ishte mësimdhënës në fshatin Rrenc. Duke parë migrimet të cilat po vazhdojnë, atij i është shuar klasa dhe ka bërë një kërkesë më datën 12.10.2023, për punësim. Për një vend të punës brenda një qendre në Komunën e Dragashit. Më datën 20.06.2024 i është dhënë një vendim nga DKA-ja, që këtij arsimtari t'i gjendet vendi i punës si punëtor mbështetës në ShFMU "Fetah Sylejmani". Kryetar, në bazë të të cilit ligj ju jeni bazuar që një punëtor klasor ta bartni si mësimdhënës mbështetës, kur jeni kryekëput kundër ligjit, i cili vend i punës nuk mund të plotësohet nga mësuesi klasor. Vendin të cilin ju i keni drejtue, atij i takon që të jetë me kurs një apo dyvjeçar për nevoja speciale. Ju mësuesin e rregullt klasor e keni drejtue dhe e keni ndalë mësimin. Çka është më e keqja, në vendimin e shënuar ju keni cekur që, në kohën kur të gjendet mundësia më e parë, të orientohet ky mësues në shkollën "Fetah Sylejmani" apo në ndonjë shkollë tjetër. Ju keni hap konkurs të ri, po me të njëjtin vend të punës, keni pranuar

punëtor të ri, e punëtorin 15-vjeçar e keni lënë si mësues mbështetës. A mund të di, ku jeni bazuar? Në çfarë ligji jeni bazuar? Derisa dihet se të gjithë punëtorët – unë pata qef ta kem këtu drejtorin e DKA-së, edhe nuk do t'i them mo si tjera herë, herën e fundit që i thashë nuk ke aftësi, je i paditur për fushën, por do t'i them nuk ke njohuri të mjaftueshme, pak më butë. Ku është bazuar që një punëtor 15-vjeçar ta çojë si punëtor mbështetës, e të hapë konkurs për vend të ri të punës? Mësuesi në fjalë ka bo edhe ankesën. Ankesa është bërë më datën 10.09.2024. Nuk i është kthyer asnjë përgjigje. Çfarë po bëhet këtu? Sipas kolegës – këto i ke zyrtare, se nuk të flas me fjalë të cilat i kam dëgjue – sipas kolegës, thotë se klasa e tretë po ndahet në dy klasë. Po formohet klasa III/1 dhe klasa III/2. Ajo klasë i numëron 12 nxënës, tash po ndahet me nga 6 nxënës. A fontanë dëshirash e keni bo këtë arsimin, apo po doni me i plotësue ato pazarllëqet të cilat i keni bo për ndonjë vend të lirë të punës të dikujt tjetër, apo jo? Këtu ka plotësisht të drejtë ligjore kolegu, dhe ju jeni kundër ligjit, që të hapni vend të ri të punës, kur është bërë kërkesa e punëtorit i cili ka punue tek ju. Është punëtor 15-vjeçar dhe ta endësh si punëtor ndihmës – i pakualifikuar është, nuk ka kualifikim për punëtor ndihmës. Nuk është drejtori që të më japë sqarim, se ndoshta është përmirësue, ka ditë shumë, tash është mësue, nuk është këtu, po më vjen keq që nuk merr pjesë në asnjë takim, pothuajse 99%, vetëm një herë e kam parë këtu. Vazhdojmë tek një shqetësim tjetër. Në seancën që shkoi, i bërë një pyetje drejtori dhe ai m'u drejtua se në bazë të informacioneve nga drejtorët e shkollave dhe ato të cilat i kam vizitue unë, të gjitha shkollat tha që janë në gjendje gatishmërie që mësimi të fillojë më 1 shtator. Tha më falni, më 2 shtator, se me 1 i bjer e diel, kështu do t'i ceki fjalët origjinal të drejtorit, tha më 2 është ditë e hënë. Çfarë po ndodh në fshatin Bresanë, ku mësimi është duke u zhvilluar në tri orare mësimore? Tri ndërrime. Sa humbën nxënësi aty – kryetar, më vjen keq për ata të cilët nuk janë mësues, unë vetë jam mësues, e di sa humb një mësues që të ketë një orar të shkurtuar. Nuk është një ditë dhe nuk është një javë. U bo një muaj, kryetar. Unë e veta, tha të gjitha shkollat janë në gjendje gatishmërie. Kam dëshirë që ta kem këtu prezent dhe të më jap përgjigje. Nëse nuk është ashtu, unë do t'i kërkoj falje, siç kam kërkuar falje për ndonjë lëshim të cilin e kam bo. Tjetra, prapë për drejtorin. Çerdhja në Dragash nuk punon që një muaj. A e kuptojmë ne – të gjithë jemi prindër dhe të gjithë kemi fëmijë, me çfarë kënaqësi ata parafilloristë e presin me shku në shkollë? Unë e kuptoj pak më ndryshe, se jam vetë mësues, edhe me çfarë kënaqësi prindërit, nëna dhe baba dëshirojnë ta çojnë atë fëmijë në parashkollorë, që ta thejë atë monotoninë si fëmijë dhe të socializohen. Bëra pyetje, kryetar, u bë një muaj dhe çerdhja është e mbyllur. Çfarë do të më jepni përgjigje, ekzekutiv? Një pyetje tjetër, po ashtu rreth arsimit, në vitin e parë kur kemi pas furnizimin me lëndë djegëse, tenderi ishte vonuar, ishte bërë në dhjetor. U pate zotue, kryetar, se për hir të kushteve meteorologjike që kemi ne, do të asistojë që tenderi të bëhet në fillim të vitit dhe furnizimi me dru djegëse dhe të njëjta – qoftë karburant apo me qymyr guri apo druri, si i shfrytëzojnë shkollat – do të kryhet gjatë verës. U krye shtatori, ne nuk kemi parë asnjë metër dru të sjellur nëpër shkolla. A është

deri diku ky projekti i afërm, apo do të vazhdojë sikur herëve tjera, atëherë kur fillojnë me ra reshjet atmosferike, qoftë shiu e qoftë bora, dhe ata punëtorë ndihmës, gjatë kohërave të lagështa do të përgatisin edhe dru për ngrohje për shkolla. Faleminderit! Sigurisht se pas këtyre përgjigjeve, kryesuesja do të më jap edhe pak hapësirë për replikë.

Uran Halimi: Tash, unë vetëm një pjesë të fjalimit e thashë më herët, s'e di a ia vlen me u kthye edhe një herë te ato kryetari që e pat për me i lënë në eventuale. Për makinën edhe motorin e saj, folëm na veç. Kryetari me një përgjigje pak më herët tha që janë do kompani të papërgjegjshme që i kanë lënë disa punë gjysmë të kryera edhe me kualitet nashta jo të mirë. Unë deshta me e pyet, kundrejt këtyre kompanive, kryetar, a janë ndërmarrë ndonjëherë masa ndëshkuese. Nëse po, cilat janë ato. Edhe nëse jo, pse, kush e bën këtë? Tash, për atë rastin e Komisionit na folëm. Është mirë, edhe ftoj grupet parlamentare të opozitës, që ne kemi të drejtë dhe mundim me e formue një komision, si delegatë të opozitës. Nuk është patjetër me qenë vendim i Kuvendit, ne kemi të drejtë për qasje në dokumentacion zyrtar dhe për me hetue parregullsitë eventuale, nëse ekzistojnë. Nëse nuk ekzistojnë, mundim me e dhënë një raport, nëse ka të gjetura ose jo. Te stadiumi i fshatit Blaç, u përmend shumë herë, kam qenë aty vetë e kam vizitue atë vendin, përveç që është lënë përgjysmë, edhe ato rrethojat e reja që i kanë bo, kryetar, kreuja janë të lëvizshme, bile-bile mundin me e rrezikue edhe jetën e qytetarëve, nëse shkojnë edhe gjenden aty afër. Janë punë maksimalisht të dobëta. Ato shtyllat që janë vendos prej betonit për me i mbajt rrethojat e stadionit të Blaçit, kreuja janë shpërbërë, betoni ekstrem i dobët. Edhe kreuja rrethojat e stadiumit të Blaçit – të ftoj me e vizitue nëse ke kohë – kreuja lëkunden, janë të montume, të vendosura, derë nuk ka stadiumi i Blaçit se është prishë. Mirëpo, edhe rrethojat që është rrethue ai stadiumi vazhdimisht lëkunden edhe rrezikojnë me shemb. Sa i përket gjendjes në arsim, kemi folë edhe më herët, s'e di edhe a ia vlen me diskutue, më herët një kërkesë e kam bo prej zyrtares për Barazi Gjimore në seancën e fundit, edhe prej kryesueses. Kryesuese, thaje do të merrem me këtë çështje, a mundesh me ma dhënë një përgjigje, çka ke hulumtue, sa je marrë edhe çka konkludoni në lidhje me qat pyetjen edhe kërkesën që ta kam bo ty, si anëtare e gruas në Dragash, edhe znj.Piraj që për momentin nuk është këtu, e cila dje më tha që, e kam hulumtue tha unë, se vetë s'kam qenë aty, e kam përcjellë tha seancën edhe debati yt, ku ti ke folë në atë seancë, s'kam mund me e gjet ose nuk është. Realisht, unë mbrëmë e përcolla seancën e muajit të kaluar edhe e pashë që është fjalimi im aty. Figuron fjalimi im në Youtube, në kanalën e Radio Sharrit. Domethënë, ose s'e ka hulumtue fare, ose e ka hulumtue gabim. E njoftoj znj.Piraj që, si bazë ligjore për me e nis këtë procedurë, është debati im në këtë Kuvend. Faleminderit shumë!

Driton Ademi: Pasi s'ma dhaje fjalën parëz, se goxha – s'e di Agroni, kolega, kënd e akuzoi, a e akuzoi kryetarin a mu, masi jemi të të njëjtit fshat po pres me i dhënë përgjigje në seancën e ardhshme. Kam disa pyetje, kryetar edhe drejtorë të cilët ndodheni këtu. E kemi ngrit një çështje, një pikë të rendit të

ditës, para disa seancave, siguria në trafik. Unë nuk e di sa je në dijëni, por rreth brenda dy javë ka pas veç prej rrugës në ku e quajmë, rrugës për Blaç, kah rruga jonë aty, vetëm për dy javë kanë qenë afër 7 aksidente. Ndoshta nuk kanë qenë shumë madhore, po kanë qenë rreth shtatë aksidente. Por brenda nëntë muajve 20 aksidente i ke pas veç në këtë rrugë. Fatmirësisht që kanë qenë me lëndime të lehta trupore. Të kam kërkuar edhe seancat e kaluara që me ndërmarrë diçka, edhe kryesueses i kam thënë, nuk e di a po e mban në mend, i kam thënë që është mirë me e thirrë edhe drejtorin e Policisë Regjionale, jo vetëm këtë tonin, por edhe mbikëqyrësi kush është i rrugëve. Atëherë, nëse ti në atë mbledhje ke thënë që nuk mundim në me marrë masa, të kuptoj që nuk mundesh me marrë masa, po pse të Vlashnja janë bo qato vizat si të bardha, si ndërprerje janë bo? Edhe ajo është rrugë magjistrale edhe është më e ngarkuar se rruga prej Tyrbes deri në Zaplluxhe. Për këtë kanë nevojë, jo veç fshati Bresanë, ka nevojë edhe Blaçi, edhe Zaplluxhja edhe shumë fshatra. Është mirë me u angazhë ma shumë për këtë. Deshta të lidhem te arsimiti. Çka ka ndodhë, kryetar, me një komision në Bresanë që e keni qit për lëndët Fizikë edhe Biologji, e keni hap konkursin edhe e keni mbyllë pas asnjë sqarim, ku nxënësit nuk janë duke i mbajur këto lëndët. E keni hap edhe e keni mbyllë në Bresanë, për lëndët Fizikë dhe Biologji. Prapë po ndërlihem te shkolla e Bresanës, drejtori nuk është këtu po...po ia bën qefin vetes se e ka marak. Riparimi i shkollës së vjetër: Kati i dytë u lye komplet po vetëm një klasë nuk u lye. Kati i parë u lye vetëm korridori, as klasët, as salla e arsimtarëve, as e drejtorit, asnjëra nuk u lye. Këtë e kam prej burimeve shumë të sakta. Edhe punëkryesi ka thënë që kaq kfidaturë – në mos gabofsha, se mundi me gabue – 500 kfidratë kuse ka thënë i kemi në projekt me i lye, klasët tjera nuk po lyhen. Domethënë ky projekti nuk po përfundohet aty në shkollë, e katërta javë nuk po fillon mësimi me orar të plotë, as me dy ndërrime. Po dal te një pyetje tjetër, te fotokopjet, që ta kam ngrit në seancë pak më herët. Fotokopjet, shkolla, furnizimi. A është e vërtetë, kryetar, që i ke pas krimet ekonomike në këto shkolla? Për këto fotokopje, që i keni pranue kuse të reja, po kanë ardhë të vjetra, që kanë qenë mbi 100 mijë fotokopje njëra i ka pas, deri te një shkollë tjetër, afër 400 mijë, saktë me numër s'mundi me të thënë, veç mbi 300, afër 400 i ka. A është e vërtetë që kanë qenë krimet ekonomike në secilën shkollë, ndoshta edhe në Gjimnaz, saktë s'po e di. Një pyetje tjetër, te shëndetësia, kur do të fillojë funksionalizimi i Laboratorit, si në QKMF këtu në Dragash, po edhe në QMF në Bresanë. Në QMF-Bresanë thuajse gati tri vjet, shumë mirë e di Samidini, dy apo tri nuk është funksionale. Por, edhe në QKMF këtu në Dragash nuk ka ... veç analiza shumë të thjeshta. Dhe pyetja e fundit, kryetar, puna e bursave të nxënësve, hala nuk ka dalë për momentin, deri më tash nuk e ke qit. Sipas informacioneve, në cilin pozicion janë marrë paret e kontratave edhe të licencave, a mos janë marrë nga grantet dhe subvencionet, që sivjet ka me pas mungesë të bursave? Nëse ka mundësi me e ditë. Faleminderit!

Afrore Vejseli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë do të jem shumë konkrete, kam dy pyetje për kryetarin. E para, kryetar, çka është duke ndodhë me ndriçimin në qytezë, tek Rruga e Brodit? Dy-

tre muaj kemi, një muaj nuk ka ndriçim. Ndriçimi publik tek Rruga e Brodit që është këtu në qytezë. Edhe pyetja tjetër, jo më pak e rëndësishme, është rryma. Rrymë kemi, kryetar, po është problemi që është shumë e dobët. Nuk e di sa është edhe kompetencë e juaja, po kisha dashta ta keni parasysh këtë. Rryma në qytezë, të paktën aty ku jetoj unë është shumë e dobët, sidomos në kohën e verës, kur kemi prezencë të madhe të diasporës, por edhe tash në kohën kur po përdoren më shumë nxemjet me rrymë. Edhe në fund, nuk e kisha lënë pa e parmend çerdhen, por po presim tetorin e famshëm, të shohim se çka do të bëni. Ju faleminderit!

Jetmir Ajdini: Kam një pyetje, kryetar, për ju. Do të ju pyes për rrugën në Gjerman, e cila është e papërfunduar. Është projekt i para gati dy viteve. Tender që është përfundue, është pague, mirëpo është edhe një pjesë e rrugës e cila ka mbet pa përfundue. Due me i ditë arsyet, pse ka mbet ajo rrugë ashtu për gati dy vite.

Shpetim Hajredini: Do të lidhem me atë akuzën pak më herët, në fjalimin e mëparshëm që na u bo për shkollën profesionale. Deshta të ju jap një sqarim të shkurtë. Shkollën profesionale ne e kemi ndërtuar, po ju keni premtuar që do ta funksionalizoni. Ne s'kemi arrit me e funksionalizue, po edhe ju, qe tri vite shkuan, nuk arritët, po edhe katër me jua dhënë, prapë s'keni me mujt me arrit. Kështu që, premtimet herën tjetër kur t'i jepni, ma kadal, me pas kujdes, s'keni nevojë më dhënë premtim kur s'mujsh me e realizue. Edhe tjetra, kam një ankesë nga një qytetar i fshatit Kapre, që firma e cila ka krye punime në atë pjesë – pronë private, në bazë të kësaj ankese të këtij qytetari që më ka ardhë – dhe një pjesë tjetër është pronë publike. Pas përfundimit të punimeve të asaj kompanie, nuk e ka rikthyer në gjendjen e mëparshme atë parcelë dhe atë rrugë që e ka dëmtue ai zotëria. Mora edhe foto prej tij, edhe video. Është mirë, kryetar, që të diskutoni me këtë zotëriun e kësaj firme, dhe le ta marrë përgjegjësinë, le të shkojë ta rregullojë atë pjesë që e ka dëmtue dhe nuk e ka kthye në gjendjen e mëparshme. Besoj që është e arsyeshme dhe e ka obligim edhe ligjor, që atë pjesë në atë vend, në atë truall që ndërhyr, punon, të kthehen në gjendjen e mëparshme. Po besoj që është edhe e moralshme që ta bëjë bile edhe ma mirë se që ka qenë më parë, e jo të lë në këtë gjendje në të cilën ma dërgoi ky zotëria foto dhe video, që ish katastrof aty, ish problem me kalue. Ma përmendi edhe drejtorin e Financave, besoj që e di se kush dhe për çka e kam fjalën. Tjetra, i nderuar kryetar: në Rregulloren të cilën e votuam na për mbeturinat, ti ma përmende një ligj atë ditë. Unë kërkova sqarim dhe të thashë ma jep këtë ligjin që ta lexoj unë, dhe ta di saktë, ndalon apo jo. Mora edhe dëgjova prapë, nja dy-tri herë, fjalimin tënd. Ndoshta ta kanë dhënë gabim ata ligjin, apo ishte leximi që ndoshta s'ke mujt me e lexue, por ligjin të cilin ti e përshkrove atë ditë unë s'mujta me e gjet kërkund. E gjeta ligjin i cili tregon saktësisht për Rregulloren e mbeturinave, i cili ishte Ligji 04/L-60 për Mbeturinat dhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 08/L-071. Ky ligj ekziston dhe e kam lexue me vëmendje, por beso që s'kam mujt me e gjet diku që e ndalon. S'jam që po due me të akuzue ty, se tek e fundit unë e kuptoj profesionin

tuaj dhe ti s'mund t'i dish të gjitha, po këtë që ta ka përshkrue dikush, nuk po e di tash a ta ka dhënë saktë apo jo. Kishte qenë mirë që në seancën e ardhshme, merre ligjin edhe, nëse nuk të pengon, ma biesh, po due me e pa këtë, ku ishte ai ligji që po e ndalon. Tjera, i nderuar kryetar, kanalizimin, ta bëra si pyetje edhe atë ditë me jetën që kem këtu, thaje nja 20 herë kemi ndërhy në kanalizimin e fshatit Kuk. Kryetar, ndoshta edhe 50 herë duhet me ndëry, po duhet patjetër. Ato pusetat të cilat janë të bllokuara, njëra është e bllokuar mos të them nja 7-8 muaj, edhe asnjëherë s'e kam diskutue këtu në Asamble. Kam prit që do të ndërhyni dhe do ta hapni, po ajo ende ish ashtu, e bllokuar. Po paraqet shumë problem të madh në atë pjesë, në ato prona të fermerëve, saqë tash janë të rrezikuar edhe bagëtia e tyre të cilat kullosin në atë pjesë. Dhe, atë ujë e përdorin për pije ato bagëti, ku dihet se çka përmban ai ujë. T'u kisha lut që, së paku brenda këtij viti këto dy puseta – dy i di që janë të bllokume – të diskutosh me kompanitë apo të gjesh ndonjë zgjidhje alternative që këto puseta të hapen dhe të mos rrezikojnë shëndetin e bagëtisë së fermerëve. Edhe një pyetje tjetër: Konkursët e punësimit në Administratë, i nderuar kryetar, i postoni në uebfaqe, apo jo? Ligjërisht, konkursët duhet të postohen në uebfaqe të Komunës, në gazetë zyrtare – e dish qysh shkojnë rregullat ligjore. Ndodh kjo apo jo? Në bazë të informacioneve që m'i dhanë mu, thanë që jo, nuk ka ndodhë një gjë e tillë. Po pres prej teje përgjigjen. Vetë absolutisht nuk kam hy me hulumtue nëse e bëni një gjë të tillë apo jo. Ju faleminderit!

Samidin Xheladini: Faleminderit kryesuese! Për hir të sqarimit, disa pjesë unë po i sqaroj vetë, me leje ose pa leje. Po ndiej përgjegjësi vetë me e dhënë, tash nashta edhe nuk janë krejt qashtu qysh po them unë, po duhet me e ditë opinionin edhe ju, edhe krejt realitetin, në qoftë se s'është qashtu, duhet tjerit që e dinë ma mirë se unë me kallxue. E vërteta duhet me dalë. Për analizat thaje, edhe e nime e di ma mirë për pjesën time, për laboratorin në Bresanë. Në vazhdimësi kemi pas probleme me furnizime. Tash mos të hyjmë pse, po unë e kam pa që, në njëfarë forme, personalisht kanë pas inate politike me mu, kryekëput politike, jo profesionale, se profesionale nuk kanë pas qysh me pas inat, se s'kanë qysh me pas. Aty nuk kanë mund, çka kanë bo, politikisht kanë dashtë me m'shantazhue. Po me gjoks e kam shty. Është shumë për keqardhje. Në Asamble, mandatin e kaluar, ka qenë Betim Merdiu kryesues, Shaban Shabani ka qenë kryetar, ka qenë tenderi për aparaturë – Krushevë e Bresanë, përveç tjerave këtu që i kanë marrë. Ambasada e Japonisë ka ardhë në Bresanë, i ka premtue edhe i ka pru. Ambasada e Japonisë i ka kursye mjetet e laboratorit, të cilat duhet me i kthye jashtë, me i çue në vend të vetin, i ka destinue për në qendrën humanitare në Bresanë edhe në Krushevë, edhe në QKMF. Kur ka ardhë aparati, ma kanë pru aparatin e vjetër. I kam thënë drejtorit i vjetër është, jo i ri, e kanë maskue. E kam hetue, për fat të mirë, i kam thënë kryetarit të Komunës, edhe Fesali ka qenë prezent, po dojnë me e pru të vjetër, drejtori po do me ma dhonë qato. S'është e mundshme, s'e ka besue që e bjer. Ose s'ia ka marrë mendja që munden me ndodhë. Por unë e kam njoftue me kohë. Kur ma kanë pru aparatin, drejtor i Drejtoratit ka qenë, drejtori i QKMF-së, ka qenë furnitori. Dhe, si e kam pa aparatin e vjetër, nuk kam

dashtë me e shti brenda. Është thirrë prej dikujt me telefon Betim Merdiu, kryesuesi Betim Merdiu e ka shti aparatën në laborator. Prej atij momentit kanë fillue edhe problemet, edhe ma madhore. Kur e kanë çelë softëerin, kanë dalë që aparati është me mijëra, dhjetëra e mijëra e qindra mijëra analiza, dhe ai aparat i biokimisë ka qenë prej të parëve. Disa herë ka qenë në servis. Çka kemi bo tash? E kemi pa që ai aparat nuk është funksional, e kanë hek, ku e kanë çue nuk e di. Kemi qit tender të ri, drejtori Behar Brenoli me stafin çka kanë bo, me kryetarin, i kemi ndarë Asambleja paret, e kemi bo një aparat tjetër. Aparati im është human, gjerman, këtu është francez. Gjithnjë tenderi del për aparatet e këtyre, tri lagjeve, Krushevë-Dragash-Bellobrad. Bresanë nuk e qesin tenderin! Mungesë absolute të reagensëve, problem madhor. Menaxhmenti këtë punë duhet me e krye, unë kam bërë kërkesa në vazhdimësi, zyrtare, me shkrim, me t'mirë e me t'keq, prapë se prapë jam injorue. Ka ardhë LDK në pushtet, kryetari i Komunës ditët e para të qeverisjes – pa i thënë, pa bisedue, ky vetë na ka thirrë, ky e di vetë qysh ka punue, se na çështjet e këtuhit nuk i bisedojmë atje – më ka thirrë edhe mu, na ka thirrë krejt zyrtarëve e na ka thënë: pare kemi, ndaç për reagensa ndaç për aparatureë, mos të ngece puna në laborator, le të vazhdojë pa asnjë pengesë. Edhe jemi zotuar që qashtu ka me shkue. Prej atij momenti kanë fillue çalimet. Unë para disa kohe, Behar Brenolin e kam pyet, a mos është sabotim, ai më ka thënë s'kam argumente. E unë sot po them: ka qenë sabotim. Le të vjen kush të dojë, unë ia argumentoj se ka qenë sabotim prej njerëzve të caktuar për këtë punë, që mos me funksionue laboratorin. Doktor, ta kam borxh prej Jeta Xharrës, doktor Jetmir, që ma ke bo pyetjen me e dhënë shpjegimin për analizat. Edhe tash kanë sabotue njerëzit në forma të ndryshme. Pushteti ka gjet forma edhe mundësi që me e funksionalizue si laboratorin qendror edhe në terren, e kam pa që ka pas angazhim maksimal. Edhe ma e keqja që njerëz të caktuar, Krushevë-Dragash edhe Bellobrad e kanë pru tenderin, e kanë qit për me e bo servisimin e aparateve, se ai duhet të bëhet në vazhdimësi – Bresanën e kanë hek. Kam ardhë e i kam lut me ma bo edhe tenderin tem, me Zyrën e Prokurimit kemi folë, me ma bo funksionalizimin e aparaturës, balansimin, kalibrimin, se janë ato aparate të ndjeshme. Nuk kanë ardhë. Edhe t'u iu thonë zyrtari i QKMF-së, shefi jem. Jo se Bresanën nuk e ke në tender, domethënë po i thotë mos shko. Jo e di ai, po kryetari nuk e di. Tash po ju kallxoj, këto janë forma ma perfide, më të ulëta të veprimit. Po bëjmë shantazhe, në mënyrë që ta akuzojmë kryetarin. Po zyrtari duhet me e krye punën e vet, se kryetari nuk mundet me shkue dhe pasulin me ia zie në shpi atje. Duhet me i ditë detyrat tona, me përgjegjësi. Unë problem kam me zyrtarët komunalë, ama unë s'un po mundem me iu drejtue kryetarit. Problem serioz kam me zyrtarët, unë kam personalisht problem. Thotë e kam procedue lëndën, s'e kam procedue. Ku është çelësi, te sabotimi është çelësi. Sevim Avdullahu, ne e bëjmë punën me përgjegjësi dhe jemi në shërbim të pacientëve. Ata na shantazhojnë, na bllokojnë. Populli po e pëson për sabotimin e tyre. Edhe duhet me shkue në përgjegjësi. Faleminderit për pyetjet që m'i bëtë, prapë jam në gjendje me iu dhënë përgjigje.

Nexhat Selaj: Nëse më lejohet edhe pak që të ndërlihem. Mbeta pak borxh tek investimet, do t'i drejtohem z.Qamilit, por edhe nënkryetarit. Ishim para dy viteve në fshatin Zym dhe vërejtëm aty një mundësi që mund ta evitojmë rreziqet në të ardhmen. Për fat të keq, deri më tani prapë nuk kemi pas ndonjë rrezik të madh, por ndeshje të vogla po përsëriten shumë shpejt. Ishit prezent, drejtor, edhe ju edhe nënkryetari, dhe u zotuat se në një të ardhme shumë të afërt do të intervenohet. U bënë dy vite, nuk kemi inetervenim. Unë nuk do t'ju lutem shumë, por në atë aspektin kolegial, si shokë, po mendoj se do të hasë në veshin tuaj, edhe pavarësisht se nuk është në këto projektet. Jeni zotue se do ta kryeni, do të ishte në të mirë të qytetarëve, jo të fshatit, por të të gjithë qytetarëve. Edhe do ta falënderoj tan Samidin për një fjalim shumë të sinqertë që e pat. Faleminderit! Je ndër ata të parët që po e pranon se vetë, në këtë ekzekutiv nuk po dëgjonu. Atë po e pranosh. Po më vjen mirë që po e pranosh dhe duhe ta pranosh, qoftë atë të mirën, qoftë edhe atë që nuk është e mirë. Do të jemi të gjithë ne të cilët do ta luftojmë bashkërisht jo të mirën, në të mirë të qytetarit. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Atëherë, unë pata pyetje për kryetarin, ai nuk është këtu dhe nuk e di nëse duhet t'ia parashtroj apo jo. Atëherë, drejtorit të Financave po ia parashtroj pyetjen. Subvencionet për fermerët, i nderuar drejtor, a do të kryhen këtë vit, apo jo? I keni mundësitë financiare apo jo? Dhe tjetra për kryetarin ishte: Ku keni mbetur me vërshimet që kanë ndodhur nëpër fshatra, a keni informacione nga qendra, nëse do të ndihmohen këto familje apo jo, dhe gjendja e rrugëve e cila është tani – po flas për fshatin Kuk – dihet. A do të ketë mundësi këtë vit të rindërtohen ato rrugë, apo jo? Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Atëherë, më janë drejtuar disa pyetje mu. E para, Uran Halimi më tha për bashkëshorten e vet. Unë kërkesë në zyrë nuk kam pas, këtu m'u ka drejtue. Në zyrë nuk kam pas edhe nuk kam. Në qoftë se e ke çue te Zyra e Kuvendit, mu nuk më ka ardhë ajo kërkesë. Të jesh i bindur. Ti këtu më ke thënë që bashkëshortja juaj është me normë të vogël, i janë përgjysmuar orët. Atëherë, unë pas Asamblesë kam lyp një takim me kryetarin e Komunës, pastaj e kam thirrë edhe drejtorin e DKA-së, sepse e kam marrë shumë me shqetësim të thellë që një grua të preket me një punë ku punon ajo. Ti pak më herët, Uran Halimi, thaje që i tradhtove për Komisionin. Si ke mund me m'bo kërkesë, kur unë tradhtoj? Mundi edhe ty me të tradhtue, në qoftë se kam tradhtue. Uran Halimi, është e vërtetë mu që më kanë votue të PDK-së, shumë e vërtetë. Po edhe shumë e vërtetë është që ti e ke votue Bexhet Xheladinin dhe sot je i tradhtuar, e tradhtarë jeni. Nuk dihet kush është tradhtue në këtë mënyrë, se as unë s'po e di, as edhe Asambleja s'e di. Ju vetë e dini kush i keni marrë qëndrimet. Unë thashë: PDK-ja më ka votue, se una jam qe 16 vjet në Asamble, se edhe unë ndonjëherë kam votue për të mirën e qytetarit dhe kam qenë me pozitën. Kështu që, jam shumë e sinqertë me ty. E dyta: Shumë herë je t'u m'thonë kryesuese, kryesuese, kqyre. Gjatë mandatit tënd dyvjeçar, asnjëherë të vetmen – edhe pse ke pas shumë parregullsi – kurrë nuk kam bo. Unë e di ku të dhëm, shumë mirë e di ku të dhëm. Por mos

harro se edhe ti ke qenë një ndër ata që ke pas dëshirë të më shohësh këtu mu. Shumë haptas ta them. Po dalim prapë te bashkëshortja juaj. Unë këtë punë do ta çoj deri në fund. Jo veç vetëm, por e kam thirrë edhe kryetaren e Grave Asamblesite. Ajo iu përgjigj ftesës dhe ne si grup do të shkojmë prapë te kryetari, dhe kjo punë, jo që besoj, po ka me u bo qindpërqind, në qoftë se është prek një asambleist në familje. Për këtë të jesh i bindur. Te Komisioni, e dini vetë që e kam votue. Nuk kam prapavijë në Komision. Aq sa ke ti dëshirë me pas edhe me nxjerrë parregullsi në Komision, në vendet që shkelet ligji ose që është korrupsioni, jam edhe unë asamblesite. Edhe mu më ka pru dikushi, si ty e si mu. Komisioni sot nuk është votue! Arsyen e dish ti dhe të gjithë asambleistët tjerë. Jo dikush që më ka vu mu dorë, se mu kërkush nuk mundet me m'rrrok. Arsyeja është që le të merret vesh VAKAT-i, kur të jenë këta gati unë e qes pikë të rendit të ditës. Këtë nuk e kam absolut, asnjë troh problem. Te pika eventuale, që thaje i ke tradhtue PDK-në. Nuk e kam tradhtue PDK-në, unë nuk jam njeri që tradhtoj. Qoftë edhe Kuvendin, nuk e kam tradhtue. Këtë nuk ma ka pas as baba i jem, as këtu ku jam e martuar, tradhtinë nuk e kishin pas në gjak. Kështu që, mos më quaj edhe një herë tradhtare! PDK-në nuk e kam tradhtue për pikën eventuale. Pikën eventuale kur e ka kërkue Driton Ademi herën e kaluar, që të dalë e dyta pas procesverbalit, atëherë jam interesue. Të gjithë kryesueset e Kuvendit që e kemi pas një takim, i kam thënë a mundem, asnjë komunë nuk e ka pikën eventuale pikë të dytë. Pikat që duhet më së shumti me u sqarue janë pikat tjera. Kjo nuk është tradhti. Mos harri, Uran Halimi, se unë 15 vjet jam në Asamble. Kurrënjëherë, bashkë me Samidinin, nuk e kemi lënë pikën eventuale edhe me dalë. Kemi qenë edhe opozitë, mundesh me e pa, i ke mediat. E ke kërkue, se dy herë ma ke thënë, edhe në Asamble po edhe jashtë. Pika eventuale nuk është edhe me u bo në çdo seancë, po këto i ka bo qeverisja tjetër, që është gjë e mirë, se neve na kanë pru votuesit që këtu na me i delegue. Në qoftë se nuk mundemi te pikat që e kemi një afat të shkurtë, mundemi në pikën eventuale. Kështu që, nuk i kam tradhtue. Kërkesat e para që i kanë pas, ato që kanë qenë për të mirën e qytetit, i kam mbështet. Këtu, pika eventuale nuk mundet me ardhë përpara, për arsye se kemi shumë çështje, e lëre më sot që ka qenë buxheti i Komunës së Dragashit. Kështu që, Uran, unë nuk jam tradhtare. Të them me plot bindje, që nesër pasnesër ke me u pendue vetë, por unë jam qajo femra që kam me e mbështet bashkëshorten tuaj. Sa je prek ti, edhe unë jam prek bashkë me këtë rastin. Faleminderit!

Gjatë dëgjimeve buxhetore që i kemi pas na si Grup i Grave Asambleiste, deshta të cekim se jemi duke e bërë një punë shumë të mirë. E falënderoj përzemërsisht kryetarin e Komunës, z.Bexhet Xheladini, bashkë me Drejtorin Qamil Kolloni, që kërkesat tona i kanë marrë parasysh. Kërkesat tona nuk kanë dalë vetëm prej grave asambleiste, por gratë që punojnë në QPS, QKMF, që punojnë në arsim, të gjitha, kanë qenë diku 10 kërkesa, të cilat kanë hy në buxhet të Komunës së Dragashit. Vlen të theksohet që, siç e cekim edhe kryetarja e Grave Asambleiste, Suada Bajrami, që gratë që janë me kancer të gjirit do të subvencionohen. Gjithmonë kryetari i ka mbështet këto, por tash e kemi një shumë jo aq edhe e madhe,

por edhe aq e vogël jo. Gratë e Komunës së Dragashit që janë të prekura me kancer – me keqardhje e them këtë – do të subvencionohen me nga 500 euro. E dyta, për opinionin, ka qenë një kërkesë nga Anesa Mehmeti që Komuna e Dragashit t'i kryejë shpenzimet për Papa Testin. Këtë e ka mirëprit shumë kryetari i Komunës, bashkë me Drejtorinë e Financave. Faleminderit!

Uran Halimi: Ishte fjala për kërkesë në zyrë. Nëse ky nuk është vendi ku bëhen kërkesat e ngriten shqetësimet e krejt qytetarëve, unë s'di çfarë kërkesë tjetër me t'bo. Edhe te Jeta (Xharra) tha ai drejtori, mu nuk m'u bo asnjë kërkesë. A u konë Urani me të takue, a të ka kallxue çka ka ndodhë? Po. Pse duhet me të bo kërkesë me shkrim, kur po dihen shkaqet edhe motivet e asaj ndodhisë, znj.Skeraj. Tash, ligjërisht ju qysh e keni qef, nëse është mirë me ligjin, është mirë gjithkrah. Tjetra, unë nuk thashë që je tradhtar, se me thënë që je tradhtar, i bjer që ti vazhdimisht tradhton. Kur unë i them dikujt tradhtar, ai vazhdimisht ka tradhtue edhe është tradhtar, ose më ka tradhtue mu personalisht. Realisht, ti na tradhtove këtu, se herën e parë na mbështete, më tradhtove edhe mu që e kërkova qato, se të pashë që seancën e kaluar e mbështete, e votove, të dytën s'e votove. Çka do me thënë kjo? Ke ndryshue mendje, mbase. Nejse, bon vaki e kam zgjedhë fjalën pak si të vrazhdë, po u zhgënjeva kur e pashë që një herë më mbështete e herën tjetër jo. Tjetra, për me qenë kryesuese s'kam mund me të mbështet, se u dashtë me dalë kundër vetes. Kam pas dëshirë me qenë ti kryesuese, kam dëshirë ti me qenë prapë kryesuese deri në fund të mandatit, nashta edhe ndonjë mandat tjetër – ku e dish, se jetës nuk i dihet – munden me zgjat. Që m'u drejtove mu për me ndërrue pikën eventuale, unë ndoshta kam protesute me ndonjë seancë, kur e kemi hup pikën eventuale, mirëpo sot unë s'bëra kërkesë për me e ndërrue pikën eventuale, me e qit të dytën ose të parën.

Arijeta Skeraj: Ti sot nuk e bëre, po sot nuk e ke bo për bashkëshorten, po unë te seancat e kalume kanë ardhë krejta që janë mbledhë, sot i thashë.

Uran Halimi: A, domethënë m'i paske mbledhë?

Arijeta Skeraj: T'i kam mbledhë krejta që mos të dal shumë herë të bëhem edhe bajat, por të dal një herë edhe t'i them të gjitha.

Uran Halimi: Mirë, znj.kryesuese. Unë zakonisht s'kam qef me i mbledhë, se duhet me i bart ato në vete. Unë i them aty për aty edhe jetoj i lirë, s'më brengos kurgjo. Është mirë, znj.kryesuese, me ma thënë nga një, se tash kur po m'i thuesh krejta po më ngarkosh, bile m'i thuj përditë e nga një, ma lehtë i pranoj, se shumë më ngarkove. Sidoqoftë, unë të falënderoj për ndihmën dhe gatishmërinë që ti e ke shpreh për me e ndihmue një rast i cili është hakmarrje politike kryekëput. Edhe tjetra, s'kam dashtë me të ofendue me atë fjalën që të thashë na ke tradhtue. Më zhgënjeve mu personalisht. S'je tradhtar në raport me mu, s'më ka ndodhë ndonjëherë. Mos i merr shumë afër zemrës, na bëjmë politikë këtu, personalet i kemi personale. Jashtë Kuvendit jemi kolegë, bën vaki shokë, me fikë familjar. Këtu është Kuvend. Mundohnu mos me na i lëndue familjet, se ata janë të pafajshëm, çka bëjmë na këtu, mbane

qetu. Ata në shpi çka bëjmë na bon vaki as idenë nuk e kanë, janë me obligime të veta secili. Për diçka që doni me u marrë me mu, unë këtu jam. Familjarët tanë nuk kanë faj. Unë shumicën e anëtarëve të familjes tuaj, bon vaki i kam shok. Djalit e kryetarit e kam pas shok të klasës. Sa herë takohemi, kemi muhabet, kurgjo s'ka ndryshue pse na politikisht nuk kuptohemi. Ata që e kanë bo tradhtinë, e marrin në vete. Unë thashë edhe prej vendit, se nuk e di a më dëgjove, unë tradhtar kurrë në jetë nuk jam ndie, edhe pse nashta jam i tradhtum.

Arijeta Skeraj: Para se me fillue me diskutime, dua t'i përgjigjem Dritonit. Ma bëri një ftesë me ia bo Drejtorisë Regjionale të Policisë. Besoj që do ta bëj këtë, Driton. Drejtorisë së Policisë do t'ia bëj shumë shpejt ftesën, dhe besoj që edhe ty do të ftoj për me e pa, në qoftë se ai pranon me marrë pjesë.

Samidin Xheladini: z.Nexhat më falënderoi. Edhe unë ty po të falënderoj që më falënderove mu. Unë jam mundue me thënë, edhe ju duhet me m'u bashkëngjit, me e gjet nëse dona me e dit të vërtetën, pse jo? Por, unë kam thënë që qeveria e kaluar dhe zyrtarët e tashëm. Të dy janë të PDK-së. Edhe të parër, edhe të dytët. Po më vjen keq, nuk dashta këtë me e thënë. Edhe të parët që kanë bo sabotime e probleme janë të PDK-së, edhe zyrtarët janë të PDK-së. Për fatë të keq, nuk është mirë me thënë, ata janë duke bërë shantazh me qëllim, që me ia ulë imazhin e kryetarit të Komunës edhe punën e tij shembullore. Angazhuesi më i madh është që me funksionue, se këtij i duhet më së shumti laboratorit. Edhe mu më ka kput t'o më çue pacientë – ndoshta kam punue dhjetëfish më tepër se që kam mujt me e përballue. Punën e dhjetë vetave e kam bo, se pacientët kanë pas nevojë. Po kjo është me qëllim. Dhe mbane në mend, në qoftë se duam me e zgjidhë problemin, është shumë lehtë. Në qoftë se duam veç me e bo me qëllim, me zhagit problemin e me pas mundësi e hapësirë me sulmue. Në qoftë se duam të bëhemi konkretë, qeky është realiteti. U bo shantazh, u bo bojkot, janë bo punë të këqija. Llogarite ti: Kërkesa i shkon drejtorit të drejtoratit, drejtori i drejtoratit hap tender. Ma ka kallxue këtu, unë e kam pa me sytë e mi, me qëllim u lënë, se niset prej shefi të laboratorit, drejtorit të QKMF-së, e çon te drejtori i drejtoratit. Drejtori i drejtoratit nuk është profesionist. Janë lënë me qëllim që, kur të konkurroje, ai i cili nuk e merr, i preferuari i tyre, me bo ankesë të bazuar. Herën tjetër e bën ankesën e çon në OShP, m'u zhagit edhe s'di sa kohë shkon. Këto krejt janë shantazhe, për mu, veç për mu, për tjerët s'di çka mendojnë.

Driton Ademi: Atëherë, Samçe, po duhet me ta përmend emrin, po s'ke të drejtë kundërreplikë tash. Kur keni ardhë në pushtet, keni thonë që na do ta bëjmë funksionale. Edhe qeshtu e keni premtue ju, që na do ta bojmë funksionale. A është zyrtar i PDK-së, a i AAK-së, a i LDK-së, kryetarit nuk i intereson. Ku po di me i interesue kryetarit për kubëzime, për kanalizime, për shumë gjëra tjera, bash ku i prek qytetarët direkt te analizat, nuk po munden me e zgjidhë problemin qe tri vjet. Thuj, Samidin, kemi dështue. Si pozitivë kemi dështue, pikë muhabetit, as nuk ke nevojë me e diskutue. Qe tri vjet thuj kemi dështue. Arijetë, nëse ka mundësi, ta kam bo një pyetje, në bazë të asambleistëve, këtu që po e lëshojnë

sallën, nuk po rrinë deri në fund, si të pozitës, si të opozitës, të gjithë po them – përveç që ka dikush pak më personale – unë kam kërkuar nëse ka mundësi, me mirëkuptimin e të gjithë Asamblesë, mundemi me e fut në pikë të dytë të rendit të ditës, pikën eventuale. Nuk ka qenë patjetër, po pasi që po e lëshojnë disa sallën, nuk është e mirë kjo. Edhe kryetar, dy pyetje, tash sa m’i çuan, nuk kam çka me të bo. Masi jam në foltore. Nja dy pyetje i kam, prej Këshillit të BI-së, Këshilli i Xhamisë së fshatit Bresanë – rregullimin e kubëzimit te muri i xhamisë, te drea e hymjes. Po dojnë me e ditë ara – edhe pse kanë bo kërkesë te ti edhe kanë bo kërkesë të tjerët, po dojnë me e ditë kur kryhet, për shkak se aty edhe po hi kombi, edhe e dish qysh është. Nëse nuk beson, merre lexoje mesazhin tash që e kam qaty. Edhe një pyetje parëz më iki po nuk ta kam bo. Të kam thënë personale, kryetar, për pastrimin e kanalizimeve në Bresanë. Asnjë kanalizim nuk e ke pastrue në Bresanë. Unë me sa e di, asnjë. Sefa po më vjen se po hapet kështu, u kput t’u i qit selfiet, se po më thojnë mos u kap me Sefon. Sefa u kput t’u qit selfie, çdo kërkesë. Të kam thënë, kryetar, a ta bëj kërkesën, direkt më ke thënë: Driton, mos e bën kërkesën, privatisht më ke thënë në korridor, më ke thënë mos e bën kërkesën se kemi me e qit një kërkesë për të gjithë fshatrat. Tender për të gjithë fshatrat, për kanalizimet, pastrimin e kanalizimeve. Unë po të them veç në Bresanë që i ke dhjetë puseta të zënta të kanalizimeve. Asnjë? Mundesh me ardhë me mu masdite, edhe kie me e pa, tek të dhjetat të çoj edhe i shohish. Është mirë këtë kërkesë me e marrë parasysh, ose me ta bo ma mirë me shkrim. Masi nuk po qesish tender, është mirë me ta bo me shkrim. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Pak, veç një replikë të vogël për tan Samidin, një sqarim të kemi njëherë e përgjithmonë. Mundesh me dalë sa herë të duash të flasësh. Të jesh i sigurt që nuk flas pa shënime. Ato çfarë i thaje, unë t’u përgjigja. Thaje po kam problem me të mijtë nëpër zyra, që nuk po m’i kryejnë punët. Unë nuk e di kush janë ata të tutë, edhe kush janë të mijtë, zyrtarët. Kuptohet, zyrtarët, unë s’po të them për familjarët, por zyrtarët. Thaje me të mijtë ma shumë po kam problem, kështu e ceke, kështu ta lexova. Dhe thashë po më vjen mirë që po dalësh dhe po i gjykosh. Nuk përmenda as të kaluarën, as të tashmen. Veç thashë, këtë kohë që ti po flasësh, e ke pushtetin në dorë. Po më vjen mirë që po flasësh në mënyrë të tillë, edhe duhet të jemi të gjithë të tillë, që të keqen ta sulmojmë, e të mirën ta mbrojmë. Pse, çka ka me ngue? Kështu e thaje, kështu t’u drejtova, mos e bart tash topin te e kaluara, e jo ata të PDK-së përpara, e të PDK-së i ke dhe sot. E ke mashën, pastroje gacën! Faleminderit!

Sefidin Mejzini: Kryesuese, faleminderit për fjalën! I nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm, përshëndetje për të gjithë! Pata qef me e pas edhe Artanin, edhe Dritonin, se i kam si më në qef kështu, kam muhabet ma shumë, me gjithë respektin për të gjithë. Driton, nuk është demokratike me na i ndalë selfiet. Mu më vjen shumë mirë që nuk keni ku me u kap, te selfiet. Kjo është shumë e bukur për qeverisjen aktuale. Në këtë vend demokratik, ti po mundohesh me na i ndalë selfiet. Duhet me pas zemër me dalë me i bo disa foto të disa punimeve. Ti nuk e ke zemrën si timen, unë në kohën e Shaban

Shabanit katër vjet jam marrë me punime edhe i kam qit krejt. Më ka akuzue Samidini. Kjo vlen për të gjithë. Kur ta shihni që po punohet keq, e drejta jote, se për këtë të kanë votue. Duhesh me i thirrë inxhinierat që s'është duke u punue mirë. E ti s'je si unë. Edhe një send – s'kam dashtë me ju thënë, me gjithë respektin që e kam për të gjithë – veç ti, Artani edhe ata që mendojnë si ti, na me qeveris me punue, me veprue, nuk kishim hy në garë zgjedhore bre burrë, hiç. Keni qenë goxha do vjet, ju kishim lënë edhe disa tjera. Po na kemi hy me një garë për me i fitue zgjedhjet edhe me punue ashtu siç dimë na, gjithmonë duke i respektue ligjet, udhëzimet e ndryshme administrative. Se tash na me bo qysh po thoni ju edhe me qeveris, na s'kishim hy në garë zgjedhore hiç, këtë duhet me e ditë. U bënë tri vjet qeverisje. Te Shpetimi – me gjithë respektin – po i thotë kryetarit për ligjin për mbeturinat. Po çohesh po propozosh me i hek veteranët. Sa veteranë jeni këtu? Po kryetari është veteran. Gjynah i Zotit, është me ndihma sociale. Kush me i pague ato, ata që s'janë në punë a? Krejt veteranët e kanë një pagë. Ky vendi ynë, Dragashi, njihet për pozitën gjeografike, për ajrin, për ujin. Edhe mbeturinat, kush do me i pastrue? Pa i pague kërkush s'i pastron. Qe çka po bëni. Me jau hek veteranëve! Kryetari është veteran. Sa veteran jeni këtu? Sevimi. Kush janë veteranët tjerë? Qamili atje, ka plot. Gjynah i Zotit, jeni me ndihma sociale, me jau hek juve 5.50 euro. A është politikë kjo? S'është politikë. Edhe del bon foto, se mu më bëhet qefi që punohet në çdo katund. Unë nuk shti sy pse është bo një qendër sportive në Bresanë. Ose të stadioni – kush më pyeti, Artani, a ka me u bo. Ka me u bo edhe në Blaç. Edhe atëherë e kam kritikue, kam thënë le të bëhet në Strazimir atje, vetëm le të bëhet në Komunë të Dragashit. Jemi hala qyteza që s'kemi hall sportive. E vetmja qytezë. Edhe ajo duhet me u bo. Nuk më mbet hatri mu pse po bëhen rrugët, ose po kubëzohen, ose po shtrohen me asfalt në bjeshkë. Po lyp investime në bujqësi e blegtori. Mu më bëhet qefi që ka shkue nëpër bjeshkë asfalti, nuk dal me kritikue. Edhe ju kamë thënë – tash, me gjithë respektin që kam – na kemi pushue 14 vjet, po kemi ardhë shumë të përgatitur, edhe po e shihni vetë që jemi duke punue shumë. Jam i sigurt që edhe për një mandat ka me pas kryetari, bashkë me qeverisjen e vet, kondicion sa të dush. Ti bën çka të dush, veç unë po ta kallxoj realitetin, sytë janë me pa. Thotë një fjalë e urtë: Trimin vra, po hakin mos ia ha. Edhe unë mund të mos jem i pajtimit, po është duke u punue. Qet ujin që po e përmend Nexha, unë kryetarit – me gjithë respektin që e kam për Shaban Shabanin – i kam thënë 7 herë ta ka rrëzue prokurimi, a e ke provue një herë me ia dhënë ai që po të rrëzon. Veç një herë bre me gabue me ia dhënë. Ta kqyrim këta tjerët a po mujn me ia rrëzue çështjen e ujit. Asnjëherë s'e ka pas guximin me ia dhënë atij. Le t'ia rrëzojshin. Qe, uji po bëhet. Qekjo qeverisje që ka ardhë, qajo po ta bjer ujin. Nuk është e vërtetë! Tash ju duhet me e kuptue që i kemi ndërrue rolet, e jona është me punue ma shumë e me diskutue ma pak. Edhe te çështja që e ngrite, tash nuk po e di sa është personale, unë e kam një vend të punës primar, punoj me nxënësit. Tash unë rri derisa duhet, veç në eventuale s'e kam pa qre me nejt, se edhe rroga jeme me të juajënm ka goxha një dallim të madh. Këtë duhet me e ditë, të jemi të qartë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Të nderuar, kërkoj mirëkuptimin tuaj, ndoshta do të marr pak kohë ma shumë, do t'ju përgjigjem pyetjeve që m'i keni bërë. Por e kam për obligim, se edhe në seancën e kaluar, edhe në seancën para kësaj më janë bërë disa pyetje që s'kam mund me iu përgjigj, për shkak se nuk është mbajtur pika eventuale e rendit të ditës. Unë ma herët, z.profesorit iu përgjigja lidhur me atë projektin e Gjinnnazit. Ndërsa, në një seancë të kaluar Dritoni më ka akuzuar se nuk ka ekzistuar projekti për renovimin, apo kubëzimin e disa rrugëve në fshatin Bresanë, edhe ndërtimi i parkut, edhe nuk ka ekzistuar shpronësimi. Unë të thashë atëherë që s'ke ditë me e gjet e s'ke ditë me e lexue. Unë ta kam prurë, që ku e ke, ta kam bërë me të verdhë, merre lexoje ku shkruan shpronësimi. Ja, këtu shkruan shpronësimi edhe, në bazë të kësaj, na e kemi paguar 20%-shin e shpronësimit të ndërtesës së SharrProdhimit. Gjithashtu, këtu e ke dokumentacionin komplet, vendimin e Asamblesë – i jemi drejtuar Qeverisë – miratimin e Qeverisë, vendimin e AKP-së që e ka pranuar vendimin e Qeverisë, edhe vendimin që janë ndarë mjetet, janë paguar parat. Mundesh me ardhë me e marrë edhe me e pa. U fol për fillimin e vitit shkollor: 7 arsimtarë mungojnë. Nuk e di këtë të dhënë, ka mundësi që është qashtu. Por e kam një të dhënë të sigurt që, edhe nëse ekziston diku ndonjë mungesë e arsimtarëve, orët janë duke u mbajtur edhe duke u plotësuar. Normal, kur të qitet konkursi, mund të ketë edhe ankesa. Për shembull, në konkursin e parë, të gjithë kandidatët që konkurojnë mundin mos me i plotësuar kushtet, duhet patjetër me u përsëritur konkursi. Sa i përket arsimtarit të mësimin klasor, për transfer. Ka ekzistuar ky problem, ai problem është zgjidhë në formën më të mirë të mundshme. I është dhënë një vendim. A është sistemuar si asistent i fëmijëve me nevoja të veçanta. Jo nuk është sistemuar si asistent, por si mësimdhënës mbështetës. Ju thatë në cilin ligj është bazuar. Se ku është bazuar, lexon në vendim. Lexoje, aty shkruan pse edhe qysh. Mirëpo, problemi i Ridvan Shabanit është zgjidhë dhe tash ai është me vendim si mësues klasor. E ka vendimin në shkollën “Fetah Sylejmani”. Unë foli me plot përgjegjësi, u zgjidh problemi. Ti je pak i vonuar me të dhëna. Ka ekzistuar, thashë, si proble, por është zgjidhë problemi ashtu siç është në mënyrë ligjore. Është mësues klasor. Nuk është nda klasa, shko kqyre, fotografo, incizo, kqyre a u nda. Është zgjidhë problemi edhe ai mo nuk ka ankesa, është i kënaqur me zgjidhjen. Ajo është e datës 12 a më herët. Unë po të them ky problem është zgjidhë. Nëse duesh me shkue me e nxit, mos me e pranue ai zgjidhjen, ajo është diçka tjetër. Ka qenë i nxitur, e kemi zbuluar, po ai faktikisht e ka pranuar një zgjidhje e cila është ligjore. Drejtori nuk është këtu, për arsyes se ka pas një takim me drejtorët e shkollave, takim që e ka caktuar drejtori rajonal i Policisë edhe komandanti i Policisë së Dragashit. Sa i përket shkollës së Bresanë, ajo është duke funksionuar edhe është duke e mbajtur mësimin në tri ndërrime, por është duke u mbajtur mësimi. Vetëm tri klasë nuk janë renovuar, për arsye se është bërë një gabim, nuk janë mat mirë ato. Punëkryesi kur i ka mat, e ka pa që tri klasë nuk janë përfshirë në paramasë. Dje inxhinier Florimi ka qenë e ka mat, edhe do ta shpallim tenderin, por kur të shkojnë fëmijët në pushim, do ta bëjmë renovimin e atyre brenda. Po ka filluar me

rregull. Jo, unë e mbaj në mend shumë mirë qysh ka thënë drejtori. Ka thënë për Restelicë. Në Bresanë ka fillue mësimi me rregull, më datën 2 shtator. Është shumë reale, mësimi ka fillue dhe është duke vazhdu normalisht. Unë përgjigjet i jap ashtu qysh i di. Folët për çerdhen, çerdhja ka qenë e përgatitur, ka qenë Komisioni, nuk e ka bo pranimin teknik, ka kërkuar edhe disa kushte shtesë. Ne nuk e kemi ditë, se për herë të parë po ndërtojmë çerdhe, as ju nuk keni pas, as na. Nuk i kemi ditë, ata i kanë lyp disa kushte shtesë. Na i kanë shkruar në letër, kanë thënë kur t'i boni edhe këto, ne e bëjmë pranimin e çerdhes. E kemi shpallë tenderim, me sa e di unë, të premtën do të përfundojnë të gjitha ato kushtet shtesë edhe Komisioni ka me ardhë me kqyrë a janë plotësuar kushtet edhe çerdhja do të hapet. Më vjen keq që ajo u vonua po, normal, kur mungon përvoja, duhet me e pranue dhe atë që nuk e din. Urani më bëri pyetje për Komisionin për automjetet. Po më vjen keq – kryesuesja s' di a ka dhënë sqarime për Komisionin, nuk kesh këtu me e dëgjue çfarë arsytimi ka dhënë. Unë po e jap arsyetimin tim. Në seancën e kaluar, kur ke thënë që të formohet Komisioni, ju e keni përmend edhe një shifër prej 53 mijë euro. Kur e keni përmend atë shifër, edhe pse ju keni lyp qasje në dokumente zyrtare, i keni kërkuar të gjitha faturat për shpenzimet e servisimit të automjeteve. Edhe i keni marrë, a i keni marrë? Ju kur thatë që janë bo shpenzime 53 mijë euro, unë kam kërkuar që kjo kërkesë e jotja të përkrahet. Pse? M'u dok shuma shumë e madhe. Pasi u krye seanca, kam kërkuar nga shërbimi financiar me m'i llogarit prej fillimit, se është fjala disa muaj. Për 17 muaj nuk i janë bo servisimet automjeteve, sepse lënda ka qenë në OShP. Deri e kemi zgjidhë problemin, ato janë shpenzime për 17 muaj. Por nuk është fjala për 53 mijë euro – 53 edhe sot ke thënë, edhe në seancën e kaluar, kqyre procesverbalin. Unë e vërtetova që nuk është fjala për 53 mijë, por është për 23 mijë euro. Ti ke gënjye, edhe pse i ke pas faturat. I ke pas të gjitha edhe kur e ke bo mbledhjen e ke bo 53 mijë, qysh me të besue unë ty, kur në Komision del nesër këtu e bën skena. Ti për 30 mijë euro i ke rrit shpenzimet e tenderit, që ke shpif. Kërkoj nga drejtori i Administratës me të ngrit padi për këtë çështje, se e ke gënjye opinionin, i ke gënjye të gjithë asambleistët. Gjithashtu ju, para dy seancave keni dalë këtu në foltore edhe keni fillue me u marrë me personalitetin tim, me biografinë time edhe me dinjitetin tim personal. Unë atë ditë nuk e kam marrë këtë punë serioze – është procesverbali, para dy seancave. Nuk e kam marrë serioze, se kam mendue që është diçka jo shumë me rëndësi, duke e marrë parasysh edhe kush po thotë. Mirëpo, kur e kam zbulue që ti bashkë me dy persona tjerë ke shkue te X personi me mbledhë shënime për mu, bile-bile e keni mësue edhe çka me thënë. Unë po të tregoj kështu: Për patriotizëm, për të kaluarën time, mua mund të ma kalojnë vetëm ata që janë te varrezat e dëshmorëve, çdo respekt për ta. Ju, bashkë me ata personat që edhe kanë shkruar për mu, duhet ta dini që kam qenë i burgosur në '93-tën, edhe kam qenë i arrestuar i fundit – jo i pari. Me arrestimin tim më janë ndërprerë të gjitha arrestimet në Komunën e Dragashit. Pse? Jo pse s'ka pas mas meje njerëz...unë nga FARK-u kam qenë i angazhuar që të formojë shtabin, kam qenë shef i Njësisë Sanitare. Unë bashkë me Dr.Hatimin, Dr.Selamiun, Dr.Xhevatin edhe

Dr.Fehmiun, kemi qenë në Shkup, me kerrin tim, i kemi blerë të gjitha pajisjet për spitalin fushor. Në 18 fshatra kemi formue depotë e barnave. E kemi pas me një fshat edhe deponë qendrore të barnave. Kanë qenë të përfshirë 35 vetë, të cilët policia serbe kërkonte nga unë që t'i jap emrat e tyre. Unë kam pranue me vdek – ata ma kanë përgatit skenarin kuse kam ik prej burgut edhe kam dalënë kufi të Shqipërisë, me m'vra – edhe këto s'i kam pranue. Të lutem, tjetër herë, Uran, të jesh shumë më i kujdesshëm. Mos hyn në biografi të njerëzve që nuk i njohish edhe mos i dëgjo njerëzit tjerë. Mos hyn në gjëra ku duesh me bo përfitime politike në këtë drejtim. Unë të kisha lut edhe një herë, mos hi në këso gjëra. Tash po kaloj te pyetjet. Për rrethojën në fshatin Blaç, që thaje, nuk besoj që është ashtu – nuk po them që nuk është, po them që nuk besoj që është ashtu, por kam me shkue me e vërtetue. Nuk ka problem, shkojmë bashkë. Te norma e bashkëshortes tuaj: Unë kam dëgjue vonë. Masi kam dëgjue, jam interesue. Është thënë 12, pastaj 14, në fund doli 16. Në shkollën e Blaçit tre arsimtarë/e të cilët janë pranuar nga qeveria e kaluar për me i dhënë 24 orë gjuhë angleze. Tani, kur është bërë ndarja e orëve, të gjithëve barabartë u janë dhënë nga tetë orë. Mirëpo, me ligj, këta të mësimit klasor kanë të drejtë me kërkue edhe lëndë zgjedhore. Tash, dy profesorët të cilët i kanë pas nga tetë orë, prindërit e tyre kanë kërkue lëndë zgjedhore Edukatë Angleze. Edhe tash, ata dy profesorët kur kanë kërkue, i kanë marrë lëndët shtesë. Bashkëshortja jotë është dashtë me dhënë mësim, por prindërit nuk kanë kërkue mësim klasor – unë po të tregoj qysh e di, ti mundesh me e kundërshtue. Mirëpo, ajo nga tetë orë tani i ka 16 orë. Unë nuk lejoj këso lloj diskriminimi me bo. Shoqja jote nëse do me iu plotësue norma, le ta bëjë një kërkesë zyrtare në DKA. Nëse DKA-ja nuk e shqyrton atë pozitivisht, atëherë hajde te unë e ankohu. Po më vjen shumë keq për ty, pse ti qe disa herë po dalish po i mbrojsht interesat personale tuat këtu në Asamble, kur i ke edhe dy asambleistë tjerë. Në vend se ata me dalë për ty me folë, po del keq. Ose ndonjëri prej asambleistëve tjerë me dalë me ta mbrojt, e jo ti vetë, po del keq ti personalisht. Për këto të trafikut u morëm vesh me Arijetën, e mori përsipër e ma zgjidhi edhe një problem. Për lëndët Fizikë dhe Biologji, nuk e di që është shpallë dhe është anulue. Por mësimi mbahet, edhe Fizikë, edhe Biologji. Por që nuk po lyen klasët, të tregova. Për fotokopjet: Është shpallë tenderi për blerjen e 16 fotokopjeve, vitin e kaluar. Procedurat janë bërë përmes Zyrës së Prokurimit. Janë kryer të gjitha procedurat, janë blerë fotokopjet, janë shpërndarë. Masi janë shpërndarë, dikush, X person, ka ngrit një padi në gjykatë, në prokurori. Prokuroria është duke e hetuar këtë problem, gjoja se këto aparatura janë të vjetra. Janë intervistuar disa persona të Komunës, duke filluar prej shefit të Prokurimit, menaxheri i kontratës, Komisioni për pranimin e mallit. Tash janë duke shkue në ato vende ku janë fotokopjet, duke i fotografuar edhe duke marrë informata prej njerëzve që janë duke punuar me atë aparaturë. Në bazë të informatave që i kemi, deri më tash është çdo gjë në rregull, nuk është zbulue asgjë që nuk është në rregull. Tash presim, unë kam besim tek hetuesia edhe tek gjykata. Ka ardhë me e vërtetue, a është e vërtetë a nuk është, punë e tyre është. Të gjitha aparatet janë në funksion. Aparate më të mira Komuna

asnjëherë nuk ka pas, shkollat asnjëherë nuk kanë pas. Shko bisedoni ju vetë me drejtorët. Shkoni në Komunë, janë në 5-6 zyra, shkoni bisedoni e kqyrni. Nuk është e vërtetë që laboratorin nuk punon askund, përveç në Bresanë edhe aty do të zgjidhet. Kemi pas probleme me furnizim me reagensa, jo që nuk kemi pas pare, e kemi shpallë tenderin disa herë. Këtu ka njëfarë lloj konflikti të interesit – edhe këta para nesh që kanë qenë e dinë – është vetëm një kompani e cila mund të furnizojë më këta reagensa. Problemin në pjesë tjera e kemi zgjidhë, tash e zgjidhim edhe në Bresanë. Nuk është tri vjet, është me muaj. Bursat: Ende është herët me e shpallë konkursin për bursa. Vitin e kaluar na i ka marrë përmbartuesi mjetet e bursave, por kemi gjet mjetet tjera dhe nuk ka dështue. Bile – bile kemi ndarë më shumë bursa se që kemi planifikue edhe plus shumë e kemi ndarë nga 100-150 euro për çdo student ma shumë sesa ka qenë e planifikuar. Pyetja e Afrores, ndriçimi publik në rrugën kah Brodi: Kemi pas disa herë probleme me këtë ndriçimin, tash është lidhë kontrata me kompaninë e cila merret me mirëmbajtjen e ndriçimit publik edhe do të zgjidhet. Edhe rryma është e dobët, ju e dini që unë e kam qit vitin e kaluar Komisionin për me e gjet një vend me e bo një trafo. Bile te hymja e juaj. Mirëpo, pastaj kemi has në pengesa në Kadastër, aty nuk po shkruajke rrugë fare. Ajo pronë ku kemi dashtë na me e vu, nuk ish pronë e jona por ajo ish pronë e një personi privat. Edhe në Kadastër, për fat të keq, në vend të ngjarjes po shihet si rrugë, por në Kadastër nuk ka rrugë. Ne nuk kemi dashtë juve me jua zënë rrugën edhe jemi tërheq. Jo pse jenu ju asambleiste, por nuk është mirë dikujt me ia vu trafon e me ia zënë rrugën. Ne kemi mendue se ajo rrugë është legale, nëse është rrugë legale ka vend edhe për trafo aty. Rrugën për Gjerman do të ishte mirë me e bo, por nuk kemi mjetet. Me mjetet e Komunës, grantit komunal, ne kemi vendos që një herë me i zgjidhë problemet brenda fshatrave. Nëse gjejmë donacione, nëse gjejmë investitorë nga ministria, ne do t'i bëjmë edhe rrugët jashtë fshatrave. Po ne nuk e kemi lënë në gjysmë, ne si qeveri në Gjerman nuk kemi shtrur rrugë. Ne as nuk kemi qit tender për Gjerman. Ne jo! Hulumtoje, unë të garantoj, se unë mbaj në mend shumë. Shkollën profesionale kemi thënë që do ta funksionalizojmë. Pasi e kam marrë detyrën, me ish-drejtorin e Arsimit dhe me Qeverinë Komunale kemi qenë e kemi parë atë shkollë, vërtet jam mahnit me madhësinë e saj, dhe që i kish të gjitha gjërat që i takon një shkollë profesionale. Është shumë keq që ajo shkollë nuk po mund të përdoret. Një gabim ka qenë aty: lokacioni. Lokacioni ma ka pamundësue edhe mu atë shkollë me e funksionalizue. Arsyeja është reagimi i qytetarëve të Dragashit, të cilët nuk pajtohen që Gjimnazin me e çue atje – se plani ka qenë shkollën fillore ku është këtu me e prish, me e bo shesh, Gjimnazin me e bo shkollë fillore dhe Gjimnazin me e çue atje. Mirëpo, reagimi i bizneseve ka qenë shumë i madh edhe ne kemi hequr dorë nga kjo. Tash atë po e shfrytëzojmë për gjëra tjera. E kemi bërë edhe depo të institucioneve komunale edhe e shfrytëzojmë për panairë. Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave: aty nuk shkruan që ti nuk guxon me e lirue askënd nga pagesa. Por në ligj shkruan: Të gjitha shërbimet që i ofron kompania regjionale duhet të paguhet. A shkruan kështu? E çka do me thënë kjo? Ne si Qeveri

Komunale kemi mundur me thënë kështu: Lirohet X- i nga pagesa, por kompenzimin kompanisë do t'ia bëjë Komuna. Ti je biznesmen, ajo kompani private që ka punëtorë, ka shpenzime edhe duhet me ia pague shërbimet asaj. Çka ta merr mendja ty, ne si Asamble Komunale me pas vendos që ti 10 mijë copë jogurt me i shit nga 1 cent. Kush t'i kompenzojke ty? Edhe ajo është kompani private, "Hidroregjioni" është kompani private, ajo funksionon në bazë të të hyrave që i grumbullon nga shërbimet që i bën. Nuk është mirë tash, ti për vete lyp subvencione këtu, çdo diskutim e ke për subvencione, a në anën tjetër kërkon që kompania t'i kryejë shërbimet e të punojë pa pare. Është njëllor sikur ty me të thënë shite jogurtin 1 cent, e me ia kompenzue Komuna që po i themi ne 1 cent. Ku me i marrë Komuna mjetet? Na me pas mjete, qato fshatrat të cilat nuk janë të kyçura ende në sistem, ua kishim paguar për një vit, me i kyç, me i mësue, me e pa që është mirë. Ju po e shihni, muajin e kaluar për kontratën kolektive nga projektet që i kemi, i kanë marrë 480 mijë euro. Tash presim kontingjentin tjetër, edhe Qeveria nuk po i merr mjetet nga Pagat dhe Shtesat, por po i merr nga projektet kapitale, për të cilat ne kemi edhe kontrata, edhe kemi me pas probleme. Edhe pyetja e fundit, a publikohen konkurset në faqen zyrtare. Po, ato publikohen. Për ata të cilët dinë me hy e me gjet, në SIMBN, faqe zyrtare. Kush do me hy, të gjitha konkurset janë aty. Edhe për Këshillin e BI-së që e paska bo pyetjen Dritoni. Kanë mbet disa punë shumë të vogla, as 1% punë. Kompanisë që e ka marrë ndoshta nja 20 herë i kam thënë. Për fund: U bë shumë zhurmë nga LVV për punësimin e Vetim Ramadanit, nga drejtor i Administratës në një pozitë tjetër, si zyrtar publik. Një zyrtar i lartë i VV-së, Filiz Mustafa, e ka dhënë një intervistë në Radio Dukagjin, ku më ka akuzue se kryetari i Komunës e ka shkelë Ligjin për Shërbyesit Civilë, Nenin 14. Në të njëjtën Radio kam dhënë edhe unë intervistë. Nja 2-3 minuta ka qenë intervista, ju keni marrë e keni shkëput nja 10 sekonda. Intervistën e Filiz Mustafës e keni dhënë krejt, intervistën time e keni lënë veç 10 sekonda, qajo që jau ka marrë mendja se ju ka konvenue. Kështu: Po më vjen keq që Filiz Mustafa është një zyrtar i lartë i LVV-së ose këshilltar i Grupit Parlamentar të LVV-së në Parlamentin e Kosovës. A është qashtu? Edhe nuk e di që Ligji për Shërbyesit Civilë, më datën 22.12.2022 është shfuqizuar. Qe ku e kam! Është shfuqizuar edhe shkruan kështu: Pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji Nr.03 L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës; Ligji për Zyrtarët Publikë dhe Ligji Nr.08 L – 128 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06 L -114 për Zyrtarët Publikë. Ky ligj qe 20 muaj nuk është në fuqi, është shfuqizuar nga Ligji për Zyrtarët Publikë. Faktikisht, ky e ka dezinformue opinionin, edhe ju sikur ata vagonët e trenit, pas lokomotivës krejt. Ai s'ka ditë, edhe ju jeni tregue të padijshëm. Filiz Mustafa më ka akuzue që po punësoj zyrtarë të lartë publikë. Zyrtarë të lartë publikë nëpër komuna janë vetëm kryetarët e komunë, ata të cilët kanë kartela VIP, edhe qeveria. Zyrtarë të lartë publikë nuk janë drejtorët. Procedurat që janë ndjek për punësimin e zotëriut në fjalë, janë zhvillue në bazë të këtij Ligji, në bazë të Rregullores QRK Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil. Është shpallë konkursi, ja ku është

konkursi, janë kryer të gjitha procedurat, edhe personi është pranue në punë si shërbyes publik dhe ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit. Po më vjen keq për z.Filiz që është nga ky vend – ju e dini që kemi pas vërshime para tre muajve, në vend se ai me u angazhue, me e përdor autoritetin e vet te Qeveria me na ndihmue për me i sanue dëmet, deri sot s’kemi asnjë cent ndihmë nga ajo. Ai atë energjinë pozitive që e ka, mirë është me i ndihmue vendit të vet, po ja që u shërbye edhe me shpifje. Faleminderit!

Uran Halimi: Kryetar, është e vërtetë, e kqyra edhe në procesverbal, kisha thënë 53 mijë euro. E kqyra vlerën totale ku e kam mbledhë të faturave, unë e kam thënë gabim. I kërkoj falje publikut, se sinqerisht kam gabue pa vetëdije. Krejtve iu kërkoja falje. Në vend se unë me thënë 23 mijë, unë kam thënë 53 mijë. A po qeshtu? E tash po due me e korrigjue, edhe me thënë para mediave edhe para juve, të nderum delegatë, që nëse kam thënë edhe e pashë që kam thënë 53 mijë, është gabim. Vlera totale e mirëmbajtjes së atyre veturave, e faturave që unë i kam kërkuë dhe më janë servue faturat, prej prillit deri në fund të korrikut, kryetar – unë qato fatura i kam, a i keni mirëmbajt a s’i keni mirëmbajt edhe qysh i keni mirëmbajt, ju e dini atë – mirëpo, për qato fatura, vlera e mirëmbajtjes së atyre veturave është 23,806 euro. Prapë është e majme, se e kam analizue çdo faturë një nga një. Për atë unë dashta me e krijue Komisionin. Le të jam unë gabim, kam dyshue, nashta jam gabim, nashta kurgjo të gjetura s’ka me pas. Pse, kryetar, hezitove me e formue atë Komision? Sidoqoftë, ke çka ke, mundim prapë me e formue Komisionin, gabimin unë e pranova, pranoje ti gabimin tënd, po e formojmë Komisionin edhe ta shohim çka ka ndodhë. Tjetra, te norma, thaje po e mbrosh interesin tënd personal. O kryetar, ish konë e pahijshme me e mbrojt interesin tem personal, me ardhë këtu me thënë s’ma ke marrë një person në punë. Ama ti me tendencë me ia hek orët, kjo është e ulët. Normal që unë kam me e mbrojt, se ti direkt në familje po më prekish. Thaje po merresh me personalitetin tem. Çka ke ndie në kafe, absolutisht nuk i qëndroj asaj. Mundesh lirisht me m’padit, m’i gjojsh argumentet edhe shkojmë ballafaqohemi me ligjin. Çka ke ndie në kafe, nëse qeverisish me kafe, kryetar, me thashëtheme të kafeve, atëherë e vazhdojmë qashtu, je i lirë prej meje, me sinqeritetin më të madh, me m’padit për atë ti që e ke ndie edhe prej kujt e ke ndie. Që t’kam thënë këtu je tradhtar, në seancë, është edhe incizimi. Prej saj nuk tërhiqem, se në raport me LVV-në je tradhtar edhe këtë e dinë krejt qytetarët. Thaje tre arsimtarë i kanë ndarë 24 orë. Unë para mediave, kam me ia servue Radio Sharrit edhe kontratën, dy kontrata të shoqes teme, që është marrë në punë me 20 orë në javë. Janë dy kontrata, kryetar. Qysh u marrë në punë ajo për 8 orë? Është marrë në punë me dy kontrata. Është kontrata e vitit 2011 me 20 orë, është kontratat me numër protokolli 13-418-15 e datës 1 shtator 2011, ku shkruhet që Jasmine Fetahu – arsimtare në shkollën “Ilmi Bahtijari”, vendi Blaç-Zaplluxhe-Zgatar, orët mësimore në javë janë 40, ma poshtë janë orët mësimore në javë 20. E kam edhe kontratën e vitit tjetër 2018, ku është rigjenerue kontrata, prapë janë 20 orë, kryetar. Çfarë kërkese me të bo unë? A t’i bije të dy kontratat,

shihni edhe llogaritë qato si kërkesë. Mandej, thajë te puna e Filizit, te puna e punësimeve, për nepotizëm je t'u u shque kohën e fundit, jo vetëm te ky rasti i ish-drejtorit, po te secili rast, i nderum kryetar. Meqenëse aty s'ka kurgjo, u shfuqizue ligji, ti qysh po e thuesh, pse keni thirrë edhe i keni lut me u tërheq dy ankues që kanë qenë për atë konkurs? Qeverisja juaj. Edhe unë s'e kam bo atë, po thajë Filizi e ka bo, LVV-ja. Pse po e marrish personale? Dy ankues të qatij konkursi i keni lut edhe ata janë tërhek. Ka ankesa edhe tjera, edhe ka me pas, kryetar. Mandej, aty dyshohet që është manipulue edhe vendi i punës. Edhe ka konflikt interesi, se mos me marrë drejtorin e vet shërbyesi civil në punë, s'ka shanca ajo me ndodhë. Sidoqoftë, te pjesa e Filizit, unë të ftoj me e padit, kryetar! Koftë kush koftë ai. Çka do me thënë nëse është këshilltar i Grupit Parlamentar të deputetëve. Padite! A ka shpif? Grahi! Padite, kryetar! S'është problem, mundish me e padit, del na demanto me dokumentacion. Sa i përket asaj të padijshëm që thajë, shkoni vagon ju. Ti me bo mos me ta bo like dhe share një piun që e ke shti në punë, e qesish prej punës. Unë ta kuptoj komplet qeverisjen tënde. A dish çka ka ndodhë? Është për keqardhje kur i marrin disa të ri, bon vaki biznesmen janë ata, ose fëmijët e biznesmenëve, i punësojnë këtu me një pagë që e dimë na si është paga, edhe i bëjnë skllavë ata. Duhet pa qare me bo like and share ata, për me i hi në qef ose me e mbajt një pozicion të punës. Nëse na jemi vagon, ti qysh po thuesh kryetar, ata piunat e tu pa qare e kanë me të bo like and share.

Nexhat Selaj: Kryetar, unë do të mundohem që rregulloren të cilën e solli kryesuesja, do ta shfrytëzoj 2 minuta. Ne mësuesit jemi të tillë, çfarë të bëjmë. The se vendimin e ke të hershëm, ne kemi lëshue vendim tash më shpejt. Unë nuk e di, për një vend të punës a duhet të lëshohen dy vendime, apo një? Ky është një vendim të cilin ju e keni lëshue më datën 20.06.2024. Nëse ju keni lëshue vendim të mëvonshëm, tash, është ankesa që e demanton atë të juajën, se ankesa është bo më datën 10.09.2024. Akoma nuk është kthye përgjigje. Kur e bëtë ju atë vendimin edhe ia dorëzuat mësuesit? Janë vendime të cilat lëshohen nga Kuvendi Komunal. Nuk flas i tha, dëgjoi, më tha. Janë këto! Unë nuk do të dua t'i prezantoj para mediave, por këto janë të shkruara dhe janë të vërtetuara, edhe me numra serikë. Tash sa m'u lajmërua personi në fjalë, tha unë nuk kam vendim. Ju thoni i kemi lëshue vendim, ai thotë nuk kam vendim. Më fal, nëse ashtu, më fal. Okej, thajë kemi dhënë vendim, kryetar. Thajë je i vonshëm me vendime, ky është vendim i ri. Unë nuk e di sa vendime lëshohen. Nëse lëshohen dy vendime për të njëjtin vend të punës, është krejt në rregull. Nëse lëshohet një, është ky. Është mësues, mësimsdhënës mbështetës, që është kundër të drejtës, kundër ligjit. Nuk munden një mësues klasor. Nëse nuk e dish ligjin, qysh po mundesh me thënë është me ligj. Unë po them nuk është me ligj. Po nuk munden, se nuk është adekuat ai. Po më shtish tash me folë edhe pak më tepër. Pse mësuesin të cilin e solle të ri, nuk e çove mbështetës? Jo bre, nuk është! E punëtori 15-vjeçar munden me shkue, a? Po mësuesi klasor ka dalë në pension, kryetar, është marrë punëtori i ri për të njëjtin vend të punës, e punëtori 15-vjeçar është çue mësues mbështetës. Unë këtë nuk po e kuptoj. E kalova minutazhën, kryesuese. Më fal!

Shpetim Hajredini: Atëherë, problem është për dy minuta me i përmbledhë të gjitha ato që pata dëshirë ta replikoj atë kolegun tim nga pozita, por do të mundohem në shpejtësi pak me i ra përkrye atyre çështjeve. E përmendi ujin e 15 fshatrave, tha ai kryetari i mëhershëm është dashtë ta ndryshojë kompaninë, e me e provue kjo tjetra a po bën ankesë, s’di çka tha. I nderuar koleg asambleist, s’di sa e dish ti, nëse kryetari juaj tash ndërhyr në projekt edhe ua jep projektet vetë ky, atëherë nuk është çështja mirë, se s’ka të drejtë kryetari me u përzie aty. Ajo shkon me prokurim, po më vjen keq. Në Zyrë të Prokurimit i çojsh ofertat edhe përzgjidhet më i liri. Veç si sqarim ta dhashë këtë, që nuk ka qenë fajtor kryetari i atëhershëm dhe, jo që nuk ka dashtë me e finalizue atë projekt – se ti e dish mirë qysh kanë shkue rrethanat, sa herë është kthye në OShP. Ne kemi bo ankesë, e krejta kanë qenë këto çështje që ti i përmende në shpejtësi, po duhet të gjitha unë me të hy edhe një herë me t’i përmend. Edhe veteranët m’i përmende, kategorinë e veteranëve, invalidëve që kam kërkue me u lirue nga pagesa. Atë edhe atë ditë e di kryetari që ia kam potencue, që kam thënë kemi mundësi na që të bëjmë rimbursim. Nëse ajo shumë po ndikojka shumë, atëherë ne si Komunë kemi mundësi buxhetore që ta përmbushim edhe atë hendek financiar të kompanisë. Ti e dish mirë këtë që e kam thënë. Tjetër është dëshira, tjetër është jo mundësia. Mundësin e ka Komuna jonë. Tjetër, konkurset publike që të thashë, kryetar, s’e di saktë a e kam potencue unë. Konkurset publike në Administratë, jo në arsim, po në Administratë a janë të publikuara apo jo, se tash e kqyra edhe një herë shënimin që ma ka bo, e ka bo konkurset publike në Administratë. Nëse janë publike apo jo këto konkurse. Po thuesh po dhe është në rregull. Edhe diçka tjetër që më bëri mu përshtypje nga ana e këtij kolegës që më akuzoi. I nderuar, ti e dish që kam pas respekt të madh unë për ty, prapë kam respekt, s’është problem. Por, nja 4 vite ti më njeh mirë mu sa kam punue për fshatin tim. Edhe prapë kisha punue po të kisha qenë, po ia kam lënë të drejtën tjetërkujt. Ata janë në pozitë dhe ata le të punojnë për fshatin. Përndryshe, ti më njeh mirë, jam kategori e jotja në këtë drejtim dhe lëshoj pe. Nuk jam unë veç i fjalëve dhe i diskutimeve këtu, por unë jam edhe i veprave. Prapë nëse më jepet mundësia pas një viti me qenë, e sheh prapë kush jam unë pastaj. Faleminderit!

Driton Ademi: Veç deshta me e plotësue kolegun Nexhat Selaj. Kryetar, kërkesën Ridvan Shabani ta ka bo më datë 12.10.2023. Ai e ka ditë që ka me shkue dikush në pension në atë shkollë, se ka qenë i “Fetah Sylejmanit”. Më datë 12.10.2023 kërkesën e ka bo në DKA, por ju keni shpallë konkurs, në mos gabofsha, në fillim të korrikut ose në fund të qershorit, për mësues të ri, kurse ky kërkesën vjet e ka bo. Qetu është duke dashtë me u ndërlihdë kolega. Ky e ka bo kërkesën për transfer, qe kërkesën ku e ke, më 12.10.2023. Ju keni hap konkurs në Dragash edhe e keni marrë tjetërkënd, këtë nuk e keni çue plotësim. Ish-drejtori yt publikisht ka thënë, një herë do ta bëjmë sistemimin e punëtorëve, tani ku ka mungesë kemi me e plotësue me punëtorë të ri. E dyta, të shpronësimi, kryetar: E mora KAB-in që e ke bo për 2025-tën, në shpronësim e ke paraqit ti shpronësimin për 2025-tën, kryetar. Edhe unë po ta jap buxhetin, unë veç munda me të thënë çka kam miratue vitin e kaluar qetu në Asamble. Unë të kam

thënë me cilin kod buxhetor i ke parapa qëto paret për shpronësim. Kurgjo nuk të kam thënë më shumë. Nuk më kanë mësue, Samidin, gabim, se jam goxha vjet. Edhe një përgjigje për Sefën. Sef, ti e dish shumë mirë se ai tenderi nuk ka mund me u dhënë qashtu ti qysh po mendojsh, që u valvit nja 7-8 vjet. Atë projektin – edhe atë ditë kryetari të Kallxo.com u livdue – projekti e ka bo PDK-ja. Shumicën e punimeve e ka bo PDK-ja në qeverisjen e vet. Projektin kush ta ka bo ty, hajt më kallxo? Sot çka ke bo ti – paramendo – pse të thashë parëz kie me u mbajt në mend si qeverisja e selfies edhe e fotove, se me qat kompani të cilën gjithmonë u ankue ti sot ke dalë edhe ke bo seflie. Plus, më e keqja, e kam fotografinë këtu ta jap, qaj person që u ankue – mos të hi shumë personale – kur e ke dhënë ti betimin, qetu ka ardhë mas teje u ulë. Pse kompanitë tjera s’po dalish me i reklamue, po veç atë? Për personat e tu është mirë me i reklamue. Mos del me i reklamue veç personat e tu, plot ke punime që mundesh me dalë edhe me i qit nëpër publik, nëpër Facebook, po vetëm atë e ke qit. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Në aspektin profesional, ka qenë çdo gjë në rregull, mirëpo me bo shpifje këtu nuk është në rregull. Duke u mundue me i mbyllë sendet, disa po mundohen me çelë çështje për të cilat janë vetë fajtorë. Po nuk po due me hy aty. Po të tregoj një send shumë të thjeshtë, Driton. Mos i politizo sendet. Mas Sefës, nuk ka nevojë më me diskutue. Ne e dimë se ti nuk mundesh me bo selfie, krejt Bresanën me allton me ta bo, se të ka mund - Kadri Veselin e Opojës - të ka mund qeky kryetari. Qeky të ka mund në Bresanë, krejt Bresanën me ta bo me allton, ti selfie nuk bojsh. Po ne kemi zemër me bo selfie edhe në Bresanë, kemi zemër me bo selfie edhe kahmos. Po ti nuk mundesh me bo, se ti nuk shohish, se shohish zi. Ty çdo punë e mirë në Bresanë që është bo, ty të duket e zezë. S’ka çka ma tepër me të bo. Kjo po të dhëm, po ne nuk mundemi me ta hek këtë dhimtën. Sa i përket personit që ka qenë këtu, ka qenë themelues i LDK-së dhe ka ardhë në cilësinë e kryetarit të parë të LDK-së, kur është bo promovimi edhe ndërrimi i pushtetit. Ti je tepër shumë i ri, në atë kohë nuk i dish lëvizjet, njerëzit edhe individët të cilët kanë marrë pjesë. Mos u mundo me propagandue, qaq po mahesh i dijsëm, por po më doket nuk je t’u ditë kurgjo. Driton, unë kam background për me i bo të gjitha lëvizjet edhe jam i zoti me i bo ato. Të lutem, nuk mundesh me m’akuzue për lëvizjet e mia. Në qoftë se flasësh për ujin, ti duhesh me e ditë që na këtu e kemi gjet një ujë, pas 4 milionë fonde që i keni pas, 5 mijë euro i kemi gjet. Edhe me 5 mijë euro kemi qenë në gjendje me rifillue prej fillimit dhe komplet me mjete vetanake me investue 3.5 milionë, edhe mos me u vërejt dëmet që i janë shkaktue këtij buxheti nga qeveria paraprake. Nuk i kemi gjykue. Edhe sot janë pasojat e investimeve fillestare të cilat i kanë bo kompanitë edhe i kanë lënë punët shumë keq. Në vend se me u mburr për metodën edhe filozofinë më të mirë të mundshme që e ka gjet kryetari për me e zgjidhë këtë problem të Ujësjellësit, ti mundohesh me polarizue. A e dish pse e polarizosh? Ti veç zi ishe duke pa, or djalë. Ti nuk po shihshe bardhë kurgjo. Nuk kemi ne mundësi ty me ta ndërrue mentalitetin, këtu është problemi. Prandaj po të them kështu. Sa u përket subvencioneve, Shpetim, ne kemi çue në Qarkoren e parë buxhetore që ta rritim numrin e

subvencioneve. Mirëpo, për me e rrit numrin e subvencioneve, të gjitha subvencionet duhet të jenë nga të hyrat vetanake. Në qoftë se e kqyr Nenin 3 të ndarjes së buxhetit, kemi mbi 73%. Ti e dish shumë mirë që ka edhe një vendim, se të hyrat nga tatimi në pronë të cilat janë ekzkluzive, duhet t'u kthehen qytetarit në infrastrukturë. Limitet të cilat na kanë lejuar për me mund me nxjerrë subvencione, me i dhënë prej të hyrave vetanake, është qajo mundësi. Sepse, kur e kemi bisedue me Ministrinë e Bujqësisë, me shumë përgjegjisi po ta them, ka thënë paratë për subvencione i jap unë. Edhe nuk na ka lejuar paratë e Grantit. Ne kemi kërkuar nga Granti i përgjithshëm ta rritim subvencionin në bujqësi. Vitin e parë kemi pas pak më shumë subvencione, për arsye se kemi inkasue pak më shumë mjete. Në qoftë se gradualisht të hyra vetanake inkasojmë më tepër sesa që kemi planifikue, ne mund të bëjmë një subvencion në bujqësi. Përkundrazi, limitet janë këto dhe qaq kanë mbet mjete që mund të subvencionojmë. Ne nuk mundim me i gënje bujqit. Për infrasstrukturë dhe investime kapitale, në qoftë se na lejohet në bujqësi me bo, do të provojmë, sepse edhe ashtu në investime kapitale, në infrastrukturë, shëndetësi dhe në arsim, pothuajse i kemi mbulue, një numër të madh të infrastrukturës e kemi rregullue nëpër fshatra. Do të na mbesin pare dhe do të mundohemi ta ndryshojmë filozofinë e shpërndarjes së buxhetit, dhe do t'i orientohemi bujqësisë dhe turizmit si dy lëmi të cilat i kemi vu edhe në PZhK dhe në Strategjinë për Zhvillimin e Turizmit, si prioritet. Prandaj, këto në aspektin profesional unë besoj se shumë kjoartë – ke të drejtë dhe do të bëjmë përpjekje bashkërisht, me këtë Kuvend, me e zgjidhë këtë problem. Por, për politizime të panevojshme nuk kemi nevojë dhe nuk do të ishte mirë me vazhduer kështu. Pavarëisht çka ndodhë me buxhetin, duhet ta dini një send: Buxheti është i rritur. Dhe në një komunë, kur ka pare ma shumë, buxheti është më i madh, ka një progres. Nuk ka vlerësim më të madh edhe s'keni nevojë me u hëngër, kur Auditori i auditon edhe vitin tjetër. Ne kemi marrë një auditim ekselent. 320 lëndë janë audituar, 6 muaj ditë u auditue ky Kuvend dhe ky Kuvend ka dalë - decidivisht shkruan opinionin e Auditorit se Pasqyrat Financiare janë konform standardeve ndërkombëtare. Nuk ka kush që mundet me i dhënë përgjigje më të mirë. Kush mund të jep përgjigje më të mirë dhe kush është organi më i lartë në Kosovë – ma gjeni – që e bën vlerësimin e pasqyrave dhe raporteve financiare, atëherë unë po ju jap përgjegjësi. Duroni edhe vitin tjetër, do t'i kemi përsëri të njëjtat auditime, sepse 324 auditime me t'u bo edhe mos me t'u gjet asnjë vërejtje, do të thotë që ka diçka në rregull këtu. Nuk është meritë e jemja, është e këtij stafit, e kësaj qeverisjeje, është e këtyre zyrtarëve që dikush mund t'i quajë PDK, dikush VV e dikush LDK. Janë njerëzit tanë dhe jemi ne. Mos i politizoni më tepër sesa që duhet do gjëra, dhe mos i folni do fjalë qaq të rënda, që nuk mund t'i tërhiqni. Prandaj, rrini pak për toke, mos filloni me këto euforizma, se me këtë metodë të akuzimit të njëri-tjetrit, jeni duke shkaktue veç probleme të panevojshme. Ne e kemi një mësues që është duke na notue, pse po e shkaktoni këtë problem.

Samidin Xheladini: Unë veç për me jua kthjellue trunin, po nisi një biografi të shkurtë me disa fjali në lidhje me biografinë e kryetarit. Keni me e dëgjue mirë, se edhe për PDK-në kam me folë. Kryetari i Komunës ka qenë në burg. Kanë thënë propaganduesit, bashkëpunëtorët, udbashët. Në mendo se kryetarin s'po e rrehin. Kur ka ardhë në shpi, ka qenë i nxirë. Unë e kam pa, i nxirë ka qenë, mas 50 ditëve masi ka ardhë në shpi. Kur u kthye ka ardhë në punë, organi i dhunshëm që e ka çue në burg, e ka respektue ligjin edhe e ka kthye në punë. Organi i dhunshëm e ka kthye në punë. Ndërsa, PDK-ja e ka qit prej punës. Dy herë ka konkurrue, e ka largue, s'e ka pranue. Edhe na s'kemi folë kurrë.

Arijeta Skeraj: Ju që keni dashtë pikën eventuale, ju kisha lut me u ulë që mos me u mbyllë seanca pa kuorum. Ju kisha lut!

Samidin Xheladini: Për punësimet ke fjala. Ju keni bo militantë edhe me kushtëzime, kubëzime, punësime, investime. Ne atë e kemi ndërprerë edhe më vjen shumë mirë. Bile-bile, mos janë përfitues më të mëdhenj prapë PDK-ja. Edhe adresoni çështjet ku duhet, se nuk është këtu me ngrit çështje pa lidhje. 20 mjekë i ka përzënë Salim Jonuzi prej Dragashit. Edhe kryesuesi i kaluar, Betim Merdiu, nuk është pranue në punë si mjek. Katër femra kanë qenë këtu, kanë konkurrue, nuk i ka pranue si mjeke, i ka marrë dy militantë të vetit edhe hiç s'kemi folë. Keni bo shkelje të rënda, kuadrot më të mira na i keni përzënë.

Arijeta Skeraj: Atëherë, Samidin, masi nuk ka kuorum, Sef në seancën tjetër, të kërkoj falje. Pasi edhe po e mbyllim këtë gjendje, gjithmonë po e lypim pikën e dytë eventuale. Në eventuale jemi dhe unë nuk jam aspak e kënaqur që po ikin e po dalin kështu. Edhe vetë po lypin, edhe vetë kryetarin e kanë lyp. Kryetarin e keni, urdhëro, bëni pyetje, Vetë po lypni, vetë po ikni, nuk është edhe kjo në rregull. Në mungesë të kuorumit, e mbyllim këtë seancë!